



**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA**



QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA


**MINISTRIA E MJEDISIT DHE
PLANIFIKIMIT HAPËSINOR**

**MINISTRY OF ENVIRONMENT
AND SPATIAL PLANNING**

**MINISTARSTVO SREDINE I
PROSTORNOG PLANIRANJA**

Komuna e Dragashit

Analiza hapësinore



Nëntor 2006

ANALIZA HAPESINORE

ANALIZA HAPESINORE – KOMUNA E DRAGASHIT

Analiza hapësinore - Komuna e Dragashit

Qëllimi

Analiza hapësinore ka për qëllim kryesor mbledhjen e informatave të një territori të caktuar, në këtë rast të komunës, procesimin e tyre në formën e një baze të të dhënave të nevojshme për trajtimin dhe trendin e zhvillimit të problemeve me të cilat ballafaqohet territori i caktuar (komuna). Paraqet gjendjen në vendbanimet e asaj komune shikuar nga aspekti ekonomik, social dhe mjedisor. Analiza hapësinore i tregon vendet ku ka probleme që lidhen me shfrytëzimin e hapësirës dhe probleme tjera, pastaj cili është trendi i zhvillimeve në hapësirë (pozitiv apo negativ) dhe në cilat vende është ai i shprehur. Në analizën hapësinore bëhet një krahasim i gjendjes së tanishme të zënjës së hapësirës (tokës) me gjendjen që ka qënë para një periudhe të caktuar kohore, tregohet dinamika, shpejtësia e kësaj zënje dhe parashikimi se çka do të ndodh në të ardhmën nese vazhdon dinamika aktuale e zënjës së tokës. Analiza hapësinore rekomandon zgjidhje për problemet dhe për ndalimin e trendeve negative të zhvillimeve në hapësirë. Ajo gjithashtu analizon ndikimin hapësinor të planeve dhe projekteve konkrete zhvillimore për të ardhmën që i ka komuna duke konstatuar se a do të jetë pozitiv apo negativ ai ndikim dhe a është zgjedhur hapësira adekuate për realizimin e projektit.

Hyrje

Kosova sot po përballet me probleme të shumta, të fushave dhe karaktereve të ndryshme, të cilat për ditë e më shumë po e ngarkojnë jetën e qytetarit e në disa momente po e sjellin në kufijtë e të padurueshmes. Aktiviteti që kemi ndërmarrë, për qëllim të fundit ka zgjidhjen e një pjese të këtyre problemeve, konkretisht zgjidhjen e problemeve më të shprehura dhe më aktuale të zhvillimit hapësinor të Kosovës. Ato janë:

- Varfëria e lartë dhe në rritje
- Papunësia e lartë dhe në rritje të vazhdueshme
- Depopullimi i vendbanimeve
- Shërbimet e ulëta shëndetësore dhe arsimore
- Degradimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore
- Humbja e tokës bujqësore
- Banimi
- Zonat e rrezikuara nga vërshimet dhe erozioni
- Shkalla e lartë e ndotjes dhe degradimi i mjedisit
- Shfrytëzimi joracional i resurseve natyrore
- Zhvillimi i pabarabartë ekonomik
- Vendbanimet, shërbimet dhe infrastruktura

Çështjet e listuara më sipër janë rezultat i takimeve të shumta me grupet ndërmministrorë, janë gjithashtu rezultat edhe i takimeve publike të organizuara në disa qendra të mëdha të Kosovës. Në të gjitha këto takime u arrit pajtueshmëri e plotë me listën e çështjeve, për të cilat në mënyrë urgjente planet komunale e në këtë drejtim edhe Plani Hapësinor i Kosovës do të duhej të ofronin zgjidhje. Ky ishte momenti kur u propozua që së bashku me strukturat komunale të të gjitha komunave të fillohet puna në analizat hapësinore komunale në mënyrë që të verifikohen dhe të

ANALIZA HAPESINORE

ANALIZA HAPESINORE – KOMUNA E DRAGASHIT

rajonalizohen çështjet e listuara të cilat për rezultat përfundimtar do ta kenë pasqyrën më reale të shtrirjes së këtyre problemeve në territorin e Kosovës.

Në këtë drejtim dhe në bashkëpunim të ngushtë me përgjegjësit komunal, kemi përfunduar analizën hapësinore të çështjeve për Komunën e Dragashit. Ky material është një bazë e mirë e të dhënave shumë të nevojshme për hartimin e planit zhvillimor komunal, të cilat në vete duhet gjithashtu të përmbajnë udhëzime dhe zgjidhje edhe për problemet eventuale specifike komunale që nuk janë temë e kësaj analize.

Rezultat i punës së përbashkët të Institutit për Planifikim Hapësinor dhe zyrtarëve të komunës së Dragashit


Përmbajtja

Profili komunal-----	6
Varfëria e lartë dhe në rritje-----	8
Papunësia e lartë dhe në rritje të vazhdueshme-----	10
Depopullimi i vendbanimeve-----	12
Shërbimet e ulëta shëndetësore-----	14
Shërbimet e ulëta arsimore-----	16
Degradimi i trashëgimisë kulturore - historike-----	18
Humbja e tokës bujqësore-----	28
Banimi-----	31
Zonat e rrezikuara nga vërshimet dhe erozioni-----	32
Ndotja dhe degradimi i mjedisit-----	35
Shfrytëzimi jo racional i mjedisit-----	37
Zhvillimi i pabarabart ekonomik-----	39
Bujqësia dhe veprimtaritë e sajë në komunën e Dragashit-----	41
Turizmi dhe potencialet turistike-----	43
Vendbanimet, shërbimet dhe infrastruktura-----	45
Përmbyllje-----	55

Profili komunal

Komuna e Dragashit përfshinë skajin jugor të rrafshit të Dukagjinit. Në veri kufizohet me komkunën e Prizrenit, në pjesën Jug-lindore dhe lindore, përmes majeve të larta të maleve të Sharrit, kufizohet me Maqedoninë, ndërsa nga Perëndimi dhe Jug-perëndimi me Shqipërinë.

Territori i komunës së Dragashit shtrihet në një sipërfaqe prej 435.25 km² dhe zë afro 4 % të territorit të Kosovës. Komuna e Dragashit ka reliev kodrinoro-malor, dhe në pjesët kufitare me Shqipërinë dhe Maqedoninë e ndajnë kurora të larta malore, ndërsa në drejtim të Shqipërisë edhe gryka të thella lumore, të pa përshtatshme për kalim. Në anën tjetër pjesa kodrinore me rënje më të butë, në drejtim të Prizrenit ofron kushte më të mira dhe ky territor lidhet përmes Prizrenit me Kosovën dhe më gjërë. Klima e komunës është submalore në vendet më të ulëta dhe malore në vende të larta. Lumi i Pllavës me degët e veta formon sistemin më të madh lumor dhe përfshin rreth 63 % të territorit të komunës. Nga tërë sipërfaqja e kësaj komune, rreth 70 % janë sipërfaqe të mbuluara me kullosa.





- Numri i banorëve në komunën e Dragashit vlerësohet rreth 47.000 banorw.
- Në qytet jetojnë 1893 banorë (afërsisht 4 % e popullsisë)
- Në fshatra jetojnë 45646 (ose 96 % e popullsisë)
- Dendësia mesatare e popullsisë është rreth 109 ban/km²
- Rritja mesatare vjetore e popullsisë në këtë komunë është 1.7 %.
- Gjithsej në këtë komunë janë afër 7325 familje, me mesataren 6.5 anëtar.



- Etnitetet që jetojnë në këtë komunë janë: shqiptarë ~60 % dhe Boshnjakë/Goranë rreth 40 %.
- Gjithësej ekzistojnë 36 vendbanime.
- Ekzistojnë dy rajone: Opoja (e banuar me shqiptar dhe ka 19 fshatra) dhe Gora (e banuar me Goran ka 16 fshatra. Në mes gjendet qyteza e Dragashit me popullat të përzier.

1. Varfëria e lartë dhe në rritje


Hulumtimet e kohëve të fundit tregojnë se varfëria në Kosovë është gjerësisht e përhapur - më tepër se gjysma e popullatës (50.3 %) jeton në varfëri, kurse 16 % e popullatës jeton në varfëri ekstreme¹. Shkalla e ulët e zhvillimit ekonomik, procesi i ngadalshëm i privatizimit, shkalla e lartë e papunësisë, sidomos të rinjtë, janë faktorë kryesorë të shkallës së lartë të varfërisë². Fakti se shkalla e varfërisë në Kosovë është më e larta në rajon, mund të thuhet se çështje kyçe në shoqërinë kosovare është varfëria.

Varfëria është një fenomen kompleks social gjerësisht e së cilës është vështirë të matet me mjete standarde. Kërkohej të dhëna të ndryshme si: Standardi jetësor, të ardhurat për kokë banori, kushtet e banimit, zgjatja mesatare e jetës, gjendja në edukimin elementar, qasja në shërbimet publike etj. Në mungesë të të dhënave si pasojë e mungesës së regjistrimit të popullsisë janë marrë për bazë numri i familjeve

dhe banorëve me asistencë sociale të cilat nuk mund të na japin një shtrirje precize të problemit, por në bazë të këtyre rezultateve mund të ndahen zonat ku ky problem është më shumë i shprehur dhe zonat me shprehje më të vogël të këtij problemi.


Të dhënat për numrin e banorëve me asistencë sociale sipas vendbanimeve janë marrë nga Qendra Sociale në komunën e Dragashit dhe kjo pjesë e popullsisë konsiderohet të jetë me varfëri të theksuar, por shkalla e varfërisë është më e madhe kur vlerësohen edhe parametra tjerë të varfërisë. Pas vlerësimit dhe analizës së të dhënave, vërehet se shkallë më të lartë të varfërisë në komunën e Dragashit kanë fshatrat Zym, Rrenc dhe Xërrxe.

Varfëria sipas vendbanimeve në Dragash



¹ WB, Maj 2004

² UNDP, Raporti i Zhvillimit Njerëzor, Kosova 2002



Mesatarja e përqindjes së banorëve që janë nën asistencë sociale (banorë të varfër) për komunën e Dragashit është llogaritur të jetë 5.5 %. Nëse e krahasojmë me dy komunat tjera të Kosovës (Vushtrrinë - 13 % dhe Suharekën - 9.5 %), Vërejmë se shkalla e varfërisë në komunën e Dragashit është pak më e vogël. Në zbutjen e këtij problemi në komunë ka ndikuar dukshëm kurbeti si një fenomen i theksuar në këtë komunë, ku ndihma e kurbetxhinjve për të afërmit ka qënë e vazhdueshme. Në përgjithësi shkallën e lartë të varfërisë në këtë komunë e ka kushtëzuar një vargë faktorësh: Është komunë periferike, jo tranzitore dhe largë qendrave të zhvilluara urbane, shkalla e ulët e zhvillimit ekonomik, shkalla shumë e lartë e papunësisë, niveli i ulët i shërbimeve shëndetësore dhe arsimore etj.

Rekomandim

- Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore do të ndihmonte në përmirësimin e shëndetit dhe ngritjen e standardit jetësor.
- Ofrimi i mundësive dhe kushteve më të mira për arsimim, do të ndihmojë në përgatitje profesionale dhe aftësimin e tyre kryesisht në lëmi specifike sipas kërkesave të tregut të punës.
- Në aspektin e edukimit dhe punësimit, vëmendje e veçantë ti kushtohet nxitjes së barazisë gjinore dhe fuqizimit të gruas e gjithashtu edhe të rinjve duke i arsimuar dhe përgatitur për punë në profesione të ndryshme. Përmirësimi i shërbimeve publike në këto hapësira do të ndikoj shumë në uljen e shkallës së varfërisë: rrugët, kanalizimi, ujësjellësi, telekomunikimet etj.
- Të planifikohet një perspektivë më e mirë për zhvillimin e bujqësisë dhe turizmit si bartësit kryesor të zhvillimit të kësaj komune.

2. Papunësia e lartë dhe në rritje të vazhdueshme

Shkalla e lartë e papunësisë në Kosovë konsiderohet si njëra nga çështjet kyçe, që reflektohet me probleme të shumta në shoqërinë kosovare. Veçorit demografike në Kosovë determinojnë përbërjen e kontingjentit të punës, siç janë popullsia shumë e re dhe emigracioni. Vlerësohet se rreth 1/3 e popullsisë së Kosovës është nën moshën 16 vjeç, ndërsa rreth 60 % e popullsisë janë në moshë pune. Shkalla e papunësisë në Kosovë është më e lartë në rajon. Popullsia shumë e re bën që ç’do vit të rritet kontingjenti i punës. Papunësia më e lartë është te personat në moshë të re (16 - 24 vjeç), kjo moshë përfshin rreth 40 % të numrit total të të papunëve. Norma e papunësisë paraqitet tepër e lartë për femra, pavarësisht nga norma shumë e lartë e jo-aktivitetit për to. Problem tjetër i papunësisë në Kosovë është edhe papunësia afatgjate, që vlerësohet se rreth 80 % e të papunëve janë të papunë afatgjatë (të papunë për më shumë se 12 muaj).


Shkalla e papunësisë në komunën e Dragashit vlerësohet ndër më të lartat në Kosovë. Të dhënat e marra nga Zyra e Punës dhe Punësimin në komunën e Dragashit tregojnë të pa punët apo punëkërkuesit e regjistruar në këtë zyre nga vendbanimet e ndryshme të Dragashit e që ky numër është shumëfish më i vogël në krahasim me numrin real të të papunëve, sepse pjesa dërmuese e të pa punëve nuk janë të

paraqitur apo evidentuar, poashtu nuk ka qenë i evidentuar edhe numri i popullsisë aktive sipas vendbanimeve, prandaj është vlerësuar përqindja e punëkërkuesve në raport me numrin e përgjithshëm të popullsisë për secilin vendbanim. Megjithatë, përmes këtyre të dhënave ne do të mund të paraqesim gjendjen afërsisht reale, duke e krahasuar gjendjen e papunësisë në mes të vendbanimeve (hapësirave) të ndryshme brenda vet komunës së Dragashit.

Vendbanimet të cilat kanë shkallë më të lartë të papunësisë, dhe janë shumë mbi mesataren e komunës janë: Pllajnik, Rrenc dhe Zym. Papunësia më e ulët paraqitet kryesisht në rajonin e Gorës, por kjo mund të jetë jo edhe aq reale sepse nga ky rajon kanë mundur të paraqiten shumë më pakë punëkërkues në zyrën komunale të punësimin, në krahasim me rajonin e Opojës.

Faktoret të cilët kanë ndikim të madh në shkallën e lartë të papunësisë në këto hapësira janë të ndryshëm.

Specifik e kësaj komune është se numri më i madh i banorëve




Jetojnë jashtë territorit të komunës se sa në vetë komunë. Migrimi i popullsisë në këtë komunë kryesisht lidhet me faktorin ekonomik dhe gjetjen e mundësive për punësim në viset tjera të Kosovës dhe në botën e jashtme. Kuadrot poashtu, për shkak të pamundësisë për punësim janë duke u shpërngulur vazhdimisht.

Pozita periferike e komunës dhe largësia nga qendrat tjera të zhvilluara e rrit problemin e punësimit. Rruga e vetme që e lidh Dragashin me pjesët tjera të Kosovës dhe me botën (rruga për Prizren) është shumë e dëmtuar dhe me shpejtësinë e kufizuar, ndikonë që kjo komunë të jetë edhe më e izoluar.

Komuna e Dragashit nuk ka patur asnjëherë industri të zhvilluar. Hidrocentrali i Dikancës që ka punësuar një numër të punëtorëve, sot nuk punon. Drateksi si i vetmi objekt industrial më i madhi në komunë kishte prodhimtari të lartë dhe punësonte mbi 600 punëtor, por pas luftës ka rënë shumë sasia e prodhimit dhe numri i punëtorëve, ndërësa sot kjo fabrikë është e privatizuar. Pas luftës ka filluar edhe zhvillimi i industrisë në sektorin privat, dhe kryesisht është zhvilluar industria ushqimore, por numri i këtyre ndërmarrjeve dhe punëtorëve të punësuar në to është i vogël dhe nuk ka mundur të ketë ndonjë ndikim të rëndësishëm në zbutjen e papunësisë.

Kushtet natyrore janë të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë e sidomos të blegtorisë, ku një numër i konsiderueshëm i banorëve të kësaj komune merren me aktivitete primare ekonomike, por edhe kjo ekonomi nuk është e zhvilluzr si duhet dhe familjet nuk mund ta sigurojnë ekzistencën nga ky aktivitet.

Niveli i ulët arsimor sidomos te femrat është faktori tjetër me rëndësi që ndikon në shkallën e lartë të papunësisë. Edhe të dhënat tregojnë se shkalla më e lartë e papunësisë është të personat e pa kualifikuar dhe te gjinia femrore.



Rekomandim

Krijimi i vendeve të lira të punës duhet të jetë në fokus të krijuesve të politikave dhe strategjisë së zhvillimit komunal. Qeveria dhe organet komunale duhet të krijojnë strategjinë e zhvillimit, politikën përkatëse të punësimit dhe të vlerësojnë se në çfarë mase politikat ekonomike ekzistuese janë në përputhshmëri me këtë qëllim primar. Aktivitetet e Zyrës Komunale të Punës dhe Punësimit në komunën e Dragashit lidhur me koordinimin e aktiviteteve në krijimin e politikave të tregut të punës (programet e trajnimit të bazuara në kërkesën e tregut, trajnimi profesional për grupe të ndryshme Gratë, të rinjtë etj.). Pagat minimale, beneficionet për të papunësuarit, tatimet dhe kontributet për të papunët duhet të analizohen me kujdes. Organet komunale të bëjnë grumbullimin e përhershëm dhe sistematik të të

dhënave mbi trendët e punësimit-papunësisë me qëllim të krijimit të sistemit informativ mbi tregun e punës dhe papunësisë.


Përkrahja e sektorit privat në avansimin dhe zgjerimin e aktiviteteve të tyre prodhuese paraqet një bazë të mirë në rritjen e punësimit në këtë komunë. Stimulimi i bujqësisë duke krijuar kushte më të mira për bujqit dhe përmirësimi i prodhimit bujqësor me ndihma konkrete si nga niveli qeveritar lokal poashtu edhe nga ai qëndror, paraqet bazë të mirë në zhvillimin e ardhshëm të komunës. Investimet në përmirësimin e infrastrukturës për të krijuar një bazë të mirë në zhvillimin e turizmit dhe përmirësimi i shërbimeve arsimore janë bazë e mirë në zbutjen e papunësisë.

3. Depopullimi i vendbanimeve

Depopullimi si dukuri shfaqet nga ndikimi i disa faktorëve: Kushteve natyrore, zhvillimit ekonomik, faktorëve social, nivelit të shërbimeve etj. Depopullimi i vendbanimeve në Kosovë shfaqet me pasoja të llojllojshme për vendbanimet që depopullohen dhe për vendbanimet ku imigron popullsia. Pasojat për vendbanimet ku ndodh depopullimi janë: Lënia e tokës pa punuar (ose punimi ekstensiv), largimi i fuqisë së re punëtore, largimi i


personave të shkolluar, zvogëlimi i martesave dhe lindjeve, paraqitja e dukurive deviate tek fëmijët dhe të rriturit etj. Në qytete ku kryesisht vendoset popullsia gjithashtu paraqiten pasoja negative si: Rritja e çmimit të banesave, zgjerimi pa plan dhe pa kontroll i qyteteve, rritja e numrit të popullsisë dhe mungesa e infrastrukturës së nevojshme, mungesa e shërbimeve etj.

Në komunën e Dragashit ekzistojnë vendbanime ku shkalla e depopullimit është shumë e lartë, si pasojë e kushteve të lartpërmendura. Harta paraqet gjendjen e depopullimit në këtë komunë. Analiza e të dhënave për shkallën e depopullimit është bërë përmes metodës komperative, sipas të cilës është vlerësuar numri i banorëve sipas vendbanimeve në vitin 1998 dhe 2005, dhe konstatimi se kemi patur rritje apo zvoglim të popullsisë për këtë periudhë kohore, duke marrë parasysh edhe shtimin e popullsisë.



Vendbanimet si: Pllajnik, Xërrxe, Lubevisht dhe Zlipotok kanë shkallë të lartë të depopullimit. Popullsia në këto fshatra është shpërngulur në mënyrë masive, ku për një periudhë kohore 5-6 vjeçare është zvogëluar shumë. Qendra kryesore gravituese e popullsisë është qyteti i Prizrenit, ku pjesa më e madhe e popullsisë së shpërngulur nga fshatrat e Dragashit është vendosur në këtë qytet. Një pjesë më e vogël e popullsisë është vendosur në qendrat tjera të Kosovës e sidomos në Prishtinë dhe një numër tjetër i konsiderueshëm janë vendosur në botën e jashtme.

Nëse krahasohet harta e depopullimit me atë të papunësisë dhe varfërisë, vërehet se viset me depopullim më të madh, kanë edhe shkallën e varfërisë dhe të papunësisë më të madhe.



Faktoret kryesor që kanë ndikuar në shkallën e lartë të depopullimit në këto vendbanime janë: Shkalla e lartë e papunësisë, varfëria, mungesa e shërbimeve, zhvillimi i pabarabart ekonomik, niveli më i ulët i shërbimeve arsimore dhe shëndetësore etj.

Rekomandim

Për zvogëlimin e shkallës së depopullimit rekomandohet që të stimulohet popullsia e këtyre vendbanimeve për veprimin dhe krijimin e kushteve më të mira për jetesë në këto hapësira. Që të arrihet ky rezultat është e nevojshme të hapen mundësi për zgjerimin e aktiviteteve ekonomike dhe investime në mjete teknike, lehtësime në shkollimin e të rinjve, përmirësimin e shërbimeve (rrugët, ujësjellësi, kanalizimi, energjia etj.), mbrojtja dhe menaxhimi më i mirë i resurseve natyrore etj.


4.1. Shërbimet e ulëta arsimore - Dragashi

Sistemi i edukimit në komunën e Dragashit është i organizuar në tri nivele: edukimi parashkollor, fillor dhe i mesëm. Në analizë është trajtuar vetëm arsimi fillor edhe atë shkollat fillore të plota të pavarura (prej klasës I - IX) si dhe arsimi i mesëm.

Në komunën e Dragashit funksionojnë 12 shkolla fillore dhe një shkollë e mesme. Paraqitja sa më reale e nivelit të shërbimeve arsimore në komunën e Dragashit është realizuar përmes analizës së indikatorëve si:

- sipërfaqja shkollore/nr. nxënësve
- gjendja fizike e objekteve
- kuadri arsimor/nr. nxënësve
- kuadri përkatës - kualifikimi i mësimeve
- largësia e objekteve shkollore

Shtrirja hapësinore e shërbimeve arsimore dhe niveli i tyre




Niveli i ulët i shërbimeve arsimore vërehet në shkollën fillore të Dragashit, Llopushnikut, Bellobradit dhe Bresanës.

Niveli mesatar i shërbimeve arsimore vërehet në shkollën fillore të Rapçës, Kosovës dhe Restelicës.

Niveli i lartë i shërbimeve arsimore vërehet në shkollën fillore të Krushevës, Brodit, Vranishtës, Kukit e cila është në ndërtim e sipër dhe në shkollën fillore të Blaqit.

Mungesa e shërbimeve arsimore



Rekomandim

Mungesa e hapësirës shkollore është e shprehur në shkollën fillore të Bellobradit dhe Bresanës. Mu për këtë arsye rekomandohet zgjerimi apo ndërtimi i objekteve të reja shkollore në këto vendbanime.

Gjendja e dobët fizike e objekteve sidomos vërehet në shkollën fillore të Llopushnikut, dhe Rapqës, pastaj në shkollën fillore të Bellobradës, Bresanës, Restelicës, Vranishtës, Brodit si dhe në shkollën fillore të Dragashit, Kosavës, Krushevës dhe shkollën e mesme të Dragashit. Shkollat kanë nevojë për investime në në rregullim të oborreve dhe të fushave sportive.

Kuadri i mjaftueshëm, pra raporti nxënës - mësimitdhënës plotëson kushtin 22nx./1mësimdhënës i përcaktuar nga MASHT.

Mungesa e kuadrit përkatës respektivisht kualifikimit të mësimitdhënësve vërehet në shkollën fillore të Dragashit, Blacit, Krushevës, Rapqit dhe Brodit. Në këtë kuptim duhet ndihmuar më tej zhvillimin profesional të punëtorëve shkencorë të rinj dhe të atyre ekzistues.


Nxënësit e vendbanimeve që gravitojnë në shkollën e mesme të Dragashit duhet të rrugëtojnë gjatë deri te shkolla e mesme e Dragashit. Gjithashtu edhe nxënësit e vendbanimeve që gravitojnë në shkollën fillore të Llopushnikut, Bellobradit kalojnë distanca të gjata të rrugës deri në shkollë. Gjithashtu vlen të përmendet rastin e tre fshatrave malorë të komunës. Nxënësit e gjinisë femërore të këtyre tre fshatrave nuk i vijojnë mësimet pas klasës së 4 të shkollës fillore. Arsye për këtë është transporti i fëmijëve. Rekomandohet që në këto vendbanime të lehtësohet mundësia e qasjes në shërbimet arsimore duke organizuar transport për nxënës.

4.2. Shërbimet e ulëta shëndetësore - Dragashi

Bartëse kryesore e kujdesit primar shëndetësor në komunën e Dragashit është Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare me pesë Qendra të Mjekësisë Familjare dhe gjashtë Ambulanca Shëndetësore. Paraqitja sa më reale e nivelit të shërbimeve arsimore në komunën e Dragashit është realizuar përmes analizës së indikatorëve si:

- objekti shëndetësor/nr. banorëve
- gjendja fizike e objekteve
- kuadri shëndetësor/nr. banorëve
- kuadri përkatës - kualifikimi i personelit mjekësor
- largësia e shërbimeve shëndetësore

Shtirja hapësinore e shërbimeve shëndetësore dhe niveli i tyre




Niveli i ulët i shërbimeve shëndetësore vërehet në ambulancën e vendbanimit të Kosavës, Blaqit, Radeshës dhe Vraniqit.

Niveli mesatar i shërbimeve shëndetësore vërehet në ambulancën e vendbanimit të Restelicës dhe në Qendrën e Mjekësisë Familjare të vendbanimit të Breznës.

Niveli i lartë i shërbimeve shëndetësore vërehet në QKMF të Dragashit, QMF të Rapçit, QMF të Bollobradit, QMF të Bresanës, QMF të Krushevës dhe ambulancën e vendbanimit të Brodit.

Mungesa e shërbimeve shëndetësore



Rekomandim

Objekti shëndetësor në raport me numrin e banorëve plotëson kushtin 1Ambulantë/6000 banorë, 1QMF/10.000 banorë, 1QKMF/100.000 banorë që don të thotë se komuna e Dragashit mbulohet sa i përket objekteve shëndetësore.

Gjendja e dobët fizike e objektit vërehet sidomos në QMF të Bresanës e pastaj në QKMF E Dragashit, Ambulancën e Kosavës, Ambulancën e Blaqit, Ambulancën e Vraniqit dhe në QMF e Krushevës. Sistemi shëndetësorë në komunën e Dragashit ka nevojë për investime të mëtejshme si në objekte, infrastrukturë ashtu edhe në mjete të punës.

Kuadri i mjaftueshëm në raport me numrin e banorëve nuk e plotëson kushtin 1mjek + 2 motra/2000 banorë i përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë. Mungesa e kuadrit vërehet sidomos në ambulancën e Kosavës, ambulancën e Blaqit, ambulancën e Radeshës, ambulancën e Vraniqit, pastaj në ambulancën e Restelicës, QMF e Breznës si dhe në QMF Bollobradit dhe QMF e Rapçit.

Poashtu vërehet qartë se kuadri aktual shëndetësor është i pa specializuar. Lidhur me këtë duhet punuar në zhvillimin e kapaciteteve të reja superiore si dhe në aftësimin e atyre ekzistuese.

Popullata e vendbanimeve që graviton sidomos në ambulancën e Brodit, ambulancën e Restelicës, QMF e Krushevës, QMF e Breznës dhe QKMF e Dragashit duhet të rrugëtojnë gjatë deri te këto shërbime shëndetësore. Gjithashtu edhe popullata e vendbanimeve që graviton në QMF e Rapçit, QMF e Bollobradës dhe ambulancën e Blaqit kalojnë distanca të gjata të rrugës deri në këto shërbime shëndetësore. Rekomandohet që në këto vendbanime të lehtësohet mundësia e qasjes në shërbimet shëndetësore duke organizuar transport për popullatën.

5. Degradimi i trashëgimisë kulturo-historike

Territori i komunës së Dragashit është i pasur me objekte të trashëgimisë kulturo - historike që nga periudhat më të lashta të saj. E kaluara historike e Komunës së Dragashit të sotëm nuk mund të shikohet e ndarë nga Prizreni dhe rrethina e tij, për shkak të lidhjes së ngushtë me qytetin dhe ka qenë si pjesë përbërëse e tij.³

Në Opojë dhe në Gorë ka mjaft gërmadha të vendbanimeve të vjetra, disa prej të cilave u kanë humbur gjurmët e disa prej tyre u ka mbetur vetëm emri si p.sh. "Zinova" si qytet i lashtë, në afërsi të Bellobradit gjenden gjurmët e lokalitetit të lashtë "Gostil" dhe gjurmë të ngjashme hasim edhe në afërsi të fshatit Brut.

Rëndësi të veçantë ka pasur rruga e ndërtuar në periudhën romake Tetovë - Shkodër - Lezhë, e cila ka kaluar nëpër malin Sharr dhe qyteti antik "Zinova" supozohet të ketë pasur rolin e qendrës regjionale tregëtare.

Në periudhën e mesjetës Opoja, Gora dhe Zgatarë kanë qenë si qendra të rëndësishme tregëtare dhe zejtare.

Në periudhën osmane shumë vendbanime kanë fituar fizionominë e qendrave të fuqishme ekonomike, edhe ato duke ndërtuar një numër të madh të objekteve fetare, rrugëve, ujësjellësve, kanalizimeve, spitaleve etj.

Kukli begu (në shek.XVI) ishte personalitet i kësaj kohe i cili ndikoi në zhvillimin ekonomik dhe kulturor të kësaj treve (Opoja dhe Gora). Ai ndërtoi xhaminë dhe tyrben pranë saj (e cila edhe sot ekziston dhe ka status të mbrojtjes) në të cilën është i varrosur ai dhe anëtarët tjerë të familjes së tij. Ka ndërtuar sarajin (shtëpi e bejlerëve), pranë saj ujësjellësin "Qeshmja e sarajit", tunelin nëntokësor (që një kohë e ka lidhur sarajin me xhaminë), namazxhahun, hamamin e shumë objekte tjera të cilat janë shkatëruar dhe janë në shkatërim e sipër.

Sot monumentet me trashëgimi kulturo - historike të kësaj komune pothuaj se janë haruar në tërësi. Nuk ka kurfarë mbështetje nga institucionet relevante lidhur me ruajtjen, mbrojtjen dhe konservimin e vlerave që i ka kjo anë dhe promovimin e tyre. Kërkesë nga niveli komunal është që të themelohet një muze komunal historik, kulturor dhe etnografik (ku do të mund të shpaloset e kaluara e kësaj ane).

Instituti Regjional për Mbrojtjen e Monumenteve të Trashëgimisë Kulturore në territorin e komunës ka evidentuar këto objekte: 25 xhami, 5 tyrbe, 7 mullinj, 8 lokalitete arkeologjike, 47 ndërtesa të arkitekturës folklorike, 2 objekte publike dhe 1 Valanicë



Foto, Valanica - objekt unikat në Kosovë që daton prej 1800 e që edhe sot funksionon, bën prodhimin e zhgunës.

³ Nga Mr. Hajriz Meleqi, Opoja dhe Gora - Vështrim gjeografik: (Komuna e Dragashit)


ANALIZA HAPËSINORE - Dragash

Vendbanimi		Trashëgimia kulturore			Trashëgimia natyrore
		Monum.e TK që kanë status dhe janë të propozuara për mbrojtje	Periudha, shekulli, viti	Vendet ku këto mon. janë të rrezikuara	Zonat me TN të rrezikuara nga shkatërimi
1	Brrut	gërmadha të kalasë	mesjetare	x	x
		xhami	shek.XX		
		xhami	shek.XX		
2	Zapluzhe	tuma	parahistori	x	x
		xhami	shek.XIX		
3	Zinovë	gërmadha të kalasë	mesjetare	x	x
4	Bresanë	gërmadha të kalasë	mesjetare	x	x
		xhami	shek.XVIII		
5	Kosavë	gërmadha të man.	mesjetare	x	x
		xhami	shek.XX	x	
6	Krushevë	misar antik	antike	x	x
7	Bellobrad	mull vala	shek.XIX	x	x
		xhami	shek.XIX		
8	Blaq	kroni	shek.XVIII	x	x
		xhami	shek.XIX		
		tyrbe	shek.XIX		
9	Orqush	obj.lok.	shek.XIX	x	x
10	Zgatar	xhami	shek.XVIII	x	x
11	Mlik	xhami	shek.XIX	x	x
12	Zym	xhami	shek.XX		
13	Kapre	xhami	shek.XX		
14	Shajne	xhami	shek.XVI		
15	Restelicë	xhami	shek.XVIII		
		xhami	shek.XIX		
		tyrbe	shek.XVIII		
16	Zlipotok	xhami	shek.XX		
17	Krushe	xhami	shek.XX		
18	Radesh	xhami	shek.XX		
		xhami	shek.XX		
19	Lubevisht	xhami	shek.XIX		
20	Kukajan	xhami	shek.XX		
21	Leshatan	xhami	shek.XX		
22	Renc	xhami	shek.XX		
23	Xerrxe	xhami	shek.XX		
24	Pllajnik	xhami	shek.XX		
		tyrbe	shek.XIX		
25	Rapq	xhami	shek.XIX		
		xhami	shek.XIX		
		tyrbe	shek.XIX		
26	Kuki	xhami	shek.XX		
27	Dragash	tyrbe	shek.XIX		
28	Buzezë	namazxhah	shek.XVI		

*Tabela me të dhëna për monumente të TK është marrë nga drejtoria për kulturë në K.K. Dragash


Sipas këtyre të dhënave, dominojnë kryesisht xhamitë 27, tyrbe 5, gërmadha të kalave 3 dhe objekte tjera (tuma, kroje, mullinjë etj.).

Trashëgimia kulturore Gjendja ekzistuese





Në hartën e Trashëgimisë kulturore të gjendjes ekzistuese vërehet se monumentet e kultit musliman janë me numër më të madh, xhamitë, pastaj tyrbet dhe aty këtu gërmadhat nga e kaluara e kësaj ane. Për mundësinë e zhvillimit të turizmit kulturor problem kryesor janë rrugët të cilat nuk janë të asfaltuara dhe mundësia e arritjes në monumente të caktuara është e vështirë.

Monumentet e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje



Monumentet që kanë status të mbrojtjes në komunën e Dragashit janë 3.

KOMUNA E DRAGASHIT				
nr.	objekti / tërësia	vendbanimi	viti i shpalljes	komente
1	Mbeturinat e kalasë në kodër "Hisarlishte" shek.II-V, nr.V.E.K.924/67	Krushevë (I - 162)	1967	
2	Xhamia e Kukli Beut shek.XVI, nr.V.E.K.925/67	Brodosavc Brodosane (I - 163)	1967	
3	Mbeturinat e objekteve fetare islame shek.XVI, nr.V.E.K.926/67	Brodosavc Brodosane (I - 164)		

Materiali është marrë nga MKRS/Divizioni i TK

Nga vizita që i është bërë këtyre monumenteve, vërehet që nuk ka kurfarë kontrolli dhe kujdesi institucional.

- Xhamia e Kukli begut - xhami e një rëndësie të madhe historike të kësaj ane, mirëmbahet nga njerëzit që jetojnë në afërsi të saj. Rruga nuk është e asfaltuar dhe çasja nuk ishte e përshtashme.
- Mbeturinat e objekteve fetare islame ("Namazxhahu")- Monument me status të mbrojtjes i pa mirëmbajtur nga askush, të cilit mund t'i humbasin edhe gjurmët nëse vazhdon të trajtohet në këtë mënyrë.
- Mbeturinat e kalasë në kodër "Hisarlishte" - nuk kemi informata për gjendjen e saj sot.



Rekomandim:

- Që të kemi një harmonizim të plotë lidhur me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, është i domosdoshëm bashkëpunimi i drejtorive komunale për kulturë me Institutet për mbrojtjen e monumenteve kulturore, MKRS-Departamentin e kulturës/ dhe me MMPH-Institutin për planifikim hapësinor. Ky bashkëpunim do të mund të rezultojë me një gjendje reale të pasurive të shumta të monumenteve kulturoro-historike që ka Kosova në tërësi dhe Komunitat në veçanti, i cili do të ketë si rezultat mbrojtjen, ruajtjen, konservimin, zhvillimin dhe promovimin e saj;
- Respektimin e legjislacionit (ligjit për planifikim hapësinor, ligjit për trashëgimi kulturore), të cilët do të mundësojnë zhvillim të qëndrueshëm të komunave në sferën e trashëgimisë kulturore dhe historike;
- Niveli komunal duhet që të ngris vetëdijen e popullatës vendase për rëndësinë e trashëgimisë kulturore;
- Të bëhet shenjëzimi i monumenteve që kanë status të mbrojtjes dhe monumenteve tjera të rëndësishme për komunën (të vihen shenjat e identifikimit të monumentit, në afërsi të tyre), do të jetë ndihmesë për turistët që e vizitojnë këtë rajon;
- Katalogu i komunës është shumë i rëndësishëm sepse përmes tij me pak fjalë dhe fotografi do të promovohen pasuritë dhe potencialet e komunës së Dragashit, i cili do të ndikojë në zhvillimin e të gjitha sferave pra, një zhvillim të gjithëmbarsuem të saj.

Trashëgimia shpirtërore si pjesë e trashëgimisë kulturore është e shprehur në shkallë më të lartë në trevën e Opojës dhe të Gorës. Etnografia e kësaj ane karakterizohet me një kolorit dhe origjinalitet që kultivohet edhe sot e kësaj dite.

Me rastin e festave të motmotit, fejesave, martesave etj. Këto veshje përdoren më shpesh dhe janë unikate për të gjitha trevat e rajonit dhe më gjerë, p.sh. veshjet e burrave (tirqi, këmishat, brezi, xhamadani etj.), veshjet e grave (këmisha, dimi, xhamadan, përparëse, çorape, shami të verdhë me theke etj.)⁴

Identitetin shpirtëror të Opojës e kompletojnë traditat shumë të ruajtura muzikore, folklorike, këngët e djepit, lindjes, dasmës, këngët dyshe, vallet në rreth, lojërat nëpër ndeje pas darke, hudhja e gurit nga krahu, kërcimi trehapësh, vrapimi i kuajve, sporti i pelivanëve etj.⁵



⁴ Nga revista mujore e K.K.Dragash, Tetor2004 - Buletini

⁵ Hajriz Meleqi - Opoja - studim kompleks gjeografik



Rekomandim:

- Të mbrohet dhe ruhet me gjelozi trashëgimia shpirtërore si formë e shprehjes kulturore të traditave popullore, zakoneve, gjuhës, festave, ritualeve, valleve, muzikës, këngëve etj., e cila e paraqet identitetin e kësaj ane dhe njëkohësisht identitetin gjithkombëtar.
- Të gjinden forma të ndryshme të promovimit të trashëgimisë shpirtërore, e cila mundë të jetë potencial i zhvillimit të kësaj komune në të ardhmen.

Degradimi i trashëgimisë natyrore

Trashëgimia natyrore në funksion të zhvillimit të turizmit

Opoja dhe Gora disponojnë me kushte shumë të përshtatshme për zhvillimin e turizmit. Faktorët që do t'a mundësonin zhvillimin e turizmit janë: peisazhet e bukura të Sharrit, klima e shëndoshë, ajri i pastër, numri i madh i burimeve dhe gurrave të ftohta, numri i madh i lumenjëve dhe luginave atraktive, pyjet, flora dhe fauna, liqejtë, tradita dhe zakonet, folklori, terrenet e përshtatshme për skijim.⁶ Analizat e shumta që janë bërë në lidhje me zhvillimin e turizmit tregojnë se në komunën e Dragashit ekzistojnë predispozita për zhvillimin e turizmit si:

Turizmi veror dhe dimëror - Terrenet për skijim janë shumë të përshtatshme në malet e Brodit, Restelicës, Radeshës, Zaplluxhës etj. (u nevoitet një shtresë e hollë e borës) dhe mundësia e shfrytëzimit për skijim dimrit mund të zgjasë deri 6 muaj në vit. Kapaciteti i terreneve të skijimit të këtyre qendrave është diku 30,000 skijatorë. Në Zaplluxhe përveq skijimit në sezonin dimrorë (në borë), terrenet janë të përshtatshme edhe për skijim në bar.

Turizmi ditë dhe rekreativo-sportiv - Sharri për nga numri i liqejve, pas Bullgarisë (malit Rilla) zë vendin e dytë në Evropë (edhe pse Opoja ka një dhe Gora ka dy liqej). Liqeni i Opojës është liqe i tipit karstik, relik i liqenit të dikurshëm (uji i të cilit mbulonte tërë fushëgropën e Opojës) me diametër ~200m', me thellësi ~10m', shtrihet në l.m.b.940m' (pika më e ulët e Opojës).

Liqejtë e Gorës janë Shutmani që shtrihet në l.m.b.2070m' dhe Defos që shtrihet në l.m.b.2112m'. Hapësira e vendndodhjes së këtyre liqejve është pa vegjetacion sepse kanë lartësi të madhe mbidetare, kanë formën e amfiteatrove dhe uji është i pastër e i ftohtë.⁷

Në strukturën e vegjetacionit, dominojnë kullosat, ndërkaq pyjet mbulojnë sipërfaqe simbolike. Livadhet shtrihen në afërsi të vendbanimeve, pa marrë parasysh lartësinë mbidetare. Regjioni i Opojës dhe Gorës është shumë i pasur me bimë mjekësore, aromatike dhe bimë tjera të rëndësishme për industrinë farmaceutike, ushqimore dhe kozmetike. Të gjitha këto që u cekën e favorizojnë zhvillimin e turizmit veror në pikat e lartëpërmendura.⁸

Turizmi edukativ - Bota bimë dhe shtazore, hidrografia dhe natyra e komunës së Dragashit në përgjithësi paraqesin burim potencial për zhvillimin e aktiviteteve hulumtuese të nxënësve, studentëve dhe shkenctarëve të ndryshëm mbrenda Kosovës por edhe të huaj.

Turizmi i gjuetisë dhe peshkatarisë - Gjuetia është duke u zhvilluar në mënyrë të kontrolluar, megjithatë është e nevojshme që të shtohet kontrolli mbi gjuajtjen e kafshëve që janë autoktone në këto hapësira sepse është duke u rrezikuar numri dhe llojet e tyre. Lumenjtë dhe përrockat e komunës së Dragashit janë shumë të pasura me trofta malore. Edhe perkundër infrastrukturës së dobët turistike vizitorë të shumtë gjatë verës vijnë nëpër lumenjtë e Dragashit për gjuajtje sportive të peshqve.

Turizmi malor - Kushtet për zhvillimin e këtij lloji të turizmit janë ideale. Këtu vlen të veqohen terrenet me pjertësi të lehtë dhe shtigjet ekzistuese të cilat i përdorin blegtorët për bagëtitë e tyre paraqesin parakusht dhe mundësi reale për zhvillimin e alpinizmit, ecjes dhe të shëtitjes malore me biçikleta. Ky lloj i turizmit ka mundësi të zhvillohet por mvaret nga zhvillimi i qendrave rekreative në këto vende.

Turizmi tranzitor - Rruga Prizren - Restelicë - Strezimir (Kufi me Maqedoninë) Fushë e Radikës e cila lidhet me rrugën Gostivar - Mavrovë - Dibër - Strugë dhe Ohër (do të asfaltohet sivjet) dhe rruga e dytë në ndërtim e sipër Prizren - Zaplluxhe - Tetovë ku prej Zaplluxhës do të lidhet me Dragashin paraqesin dy segmente me rëndësi për zhvillimin e turizmit tranzitor në territorin e komunës së Dragashit. Hapja e këtij

⁶ Materiali është marrë nga web-faqja e KK Dragash

⁷ Nga Mr. Hajriz Meleqi, Opoja dhe Gora - Vështrim gjeografik (Komuna e Dragashit)

⁸ Materiali është marrë nga web-faqja e KK Dragash


vendkalimi kufitar do t'i ndihmojë Dragashit që të jetë nyje më të afërt për banorët e Magedonisë Perëndimore e cila do të lidhë këtë pjesë me Autostradën Durrës - Kukës - Prishtinë - Merdare.

Në hartën e mëposhtme janë të paraqitura pasuritë natyrore të Komunës së Dragashit në funksion të zhvillimit të turizmit.

Rekomandim:

- Të respektohen parimet udhëzuese të politikës për mbrojtjen e mjedisit;
- Respektimi i legjislacionit si: Ligji për planifikim hapësinor, ligji për mbrojtje të mjedisit dhe ligji për mbrojtje të natyrës, do të jenë ndihmesë e madhe për mbrojtje të mjedisit konform zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik në Kosovë;
- Bashkëpunimi i nivelit qendror (MMPH, MKRS dhe MTI), Instituteve për mbrojtjen e mjedisit dhe nivelit lokal (drejtoritë për mjedis) duhet të jetë i domosdoshëm me qëllim të harmonizimit të mbrojtjes së trashëgimisë natyrore si potencial i zhvillimit të gjithëmbarshtëm të Kosovës;
- Të stimulohet zhvillimi i turizmit me investime në infrastrukturë fizike dhe hotelere, përmes promovimit të vlerave të trashëgimisë natyrore që i ka kjo anë, që do të jetë potencial për zhvillimin ekonomik të komunës dhe Kosovës në përgjithësi.


Trashëgimia natyrore Gjendja ekzistuese - Komuna e Dragashit



6. Humbja e tokës bujqësore

Humbja e toks bujqësore është çështje tjetër me të cilën ballafaqohet Kosova. Vlerësohet se në Kosovë humbin rreth 2600 - 3000 ha të tokës bujqësore në vit (këto të dhëna janë marrë nga MBPZHR, “raporti mbi gjendjen e tokave bujqësore që janë atakuar nga ndërtimet e egra dhe propozimi i masave për parandalimin e kësaj dukurie”).


Në komunën e Dragashit kemi pjesëmarrje të konsiderueshme të tokës bujqësore. Nga sipërfaqja e përgjithshme e komunës që është 43524.49 ha, 77.9 % apo 33903.5 ha është tokë bujqësore, ndërësa sipërfaqet jobujqësore përfshijnë 22.1 % apo 9621 ha.



Një specifikë në këtë komunë është se 64.5 % e tokës bujqësore është në pronësi shoqërore dhe 35.5 % në pronësi private. Pjesën më të madhe të tokave bujqësore e menaxhon „Sharr Prodhimi” që është në pronësi shoqërore. Aktualisht, janë duke u zhvilluar konsultime për privatizimin e „Sharr Prodhimit”, i cili ka sipërfaqe të mëdha të tokës (mbi gjysmen e


territorit të komunës).

Në sipërfaqen e përgjithshme bujqësore, në këtë komunë dominojnë sipërfaqet me livadhe dhe kullosa (79.8 %), dhe kjo dallohet në nivel të Kosovës. Pastaj, vijnë pyjet me 18.7 %, ndërësa sipërfaqet e tokave të punueshme (me drithra, perime etj.) përfshijnë sipërfaqe jashtëzakonisht të vogël dhe zvoglimi i këtyre sipërfaqeve në masë të madhe ka ndodhur sidomos kohëve të fundit, ku numër i madh i ekonomive shtëpiake i kanë shëndrruar gati të gjitha arat në livadhe.



Këtë përbërje të strukturave bujqësore e kanë kushtëzuar kushtet natyrore duke përfshirë: Relievin, përbërjen gjeologjike, klimën, hidrografinë dhe përbërjen pedologjike.

Përqindja e tokës bujqësore dhe asaj jo bujqësore në nivel të vendbanimeve (sipërfaqeve katastrale të tyre) është mjaft e ndryshme.




Mbi 80 % tokë bujqësore kanë 16 vendbanime, 60 - 80 % tokë bujqësore kanë 11 vendbanime, 40 - 60 % kanë 7 vendbanime, një vendbanim ka mbi 20 % tokë bujqësore ndërsa një vendbanim nuk ka patur të dhëna (është fjala për fshatin Pllajnik). Të dhënat tregojnë se rreth gjysma e vendbanimeve kanë mbi 80 % tokë bujqësore.

Humbja e tokës bujqësore në komunën e Dragashit nuk është problem edhe aqë serioz, për faktin se në këtë komunë nuk kemi ndonjë zonë të madhe urbane apo zhvillime të theksuara. Humbja e përhershme tokës bujqësore shkaktohet nga zgjerimi i Vendbanimeve, komunikacioni, veprimtarive komerciale - shërbyese - tregtare, akumulimet e ujit etj. Por, kjo humbje që është e pa kthyeshme nuk është edhe aq e lartë , sepse vendbanimet (në përjashtim të atyre më të mëdha) nuk janë duke u zgjeruar tej mase. Infrastruktura dhe objektet tjera poashtu kanë përhapje të kufizuar.

Humbjet e përkohshme të tokës bujqësore bëhen nga, proceset e erozionit dhe të vërshimeve, degradimet e ndryshme, gërryerjet e lumenjve, deponitë e mbeturinave komunale, deponitë e mbeturinave industriale etj. Në këto humbje kërkohen veprime konkrete siq janë ato antierozive, për mbrojtjen e vegjetacionit, rregullimit të lumenjve etj. në të gjitha ato zona ku këto probleme janë të shprehura.

ANALIZA HAPESINORE

ANALIZA HAPESINORE – KOMUNA E DRAGASHIT



Rekomandohet:

- Parandalimi i humbjes së tokave bujqësore, gjeëjësht zhvillimi i politikave hapësinore në nivelin komunal, harmonizimi i tyre me nivelin qendror që kjo dukuri të parandalohet sa më shpejt
- Rritja e vendbanimeve të bëhet në atë mënyrë që të ruhen toka e kategorisë më pjellore me bonitetet III dhe IV
- Shfrytëzimi i sipërfaqeve të mëdha të kullosave për zhvillimin e blegtorisë dhe të gjendet një zgjidhje e mirë në lidhje me Sharrprodhimin.
- Të punohet toka, sidomos të sipërfaqet me kategori tre dhe kater.

7. Kualiteti i banimit

Çështja e banimit trajtohet në aspekte të ndryshme (kualiteti i jetës, të ardhurat, shkalla e varfërisë, punësimi, arsimimi, infrastruktura shërbyese, shërbimet publike etj.), të gjitha këto janë të ndërlidhura dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në kualitetin e banimit.

Dragashi si komunë numëron rreth 47.000 banorë nga të cilët 1893 ose rreth 4 % jetojnë në qytezë (Dragash) dhe rreth 96 % e popullsisë jetonë në 35 fshatra. Numri i familjeve është rreth 7300 me mesatarën e anëtareve 6.5, dhe kemi një dendësi mesatare rreth 109 banorë në një km².

Vendbanimet e komunës së Dragashit i takojnë tipit të grumbulluar, ku shtepitë janë të ndertuara afër njëra-tjetrës.. Në krijimin e këti tipi kanë ndikuar faktorët gjeografikë, politikë, socialë, ekonomikë dhe psikologjikë. Këto vendbanime përbëhen nga mahallët (lagjet) të cilat në të shumtën e rasteve përbëhen prej një fisi, por kemi raste kur atë e përbëjnë dy e më tepër fise. Vendbanimet në përgjithësi shtrehen në lartësi mbidetare mbi 1000 m, dhe dendësia e tyre është rreth 9 vendbanime në 100 km², ndërësa distanca mesatare e vendbanimeve është rreth 10 km. Vendbanimet në rajonin e Gorës kanë dendësi më të vogël dhe disatancë më të madhe, kurse në atë të Opojës dendësia është më e madhe dhe distanca mes vendbanimeve më e vogël. Këta parametra tregojnë kjo komunë hynë në kuadër të rajoneve më të banuara në Kosovë. Sa i përket funksionalitetit të vendbanimeve, gati në të gjitha domonon tipi agraro-blegtoral, dhe me disa aktivitete shumë të vogla zejtaro-tregëtare. Përjashtim bënë qyteza e Dragashit në të cilën dominojnë kryesisht aktivitetet shërbyese pasi që është edhe qënder administrative për këtë hapësirë.

Komuna e Dragashit është gati tërësisht hapësirë rurale gjë që nuk mund të mendohet për ndonjë urbanizim në kuptimin e tij të ngushtë⁹. Mirëpo, po qe se fshatrave të komunës së Dragashit i qasemi përmes një analize më të thellë në pikëpamje të transformimit të përgjithshëm, mund të mendohet se këtu ka filluar dhe po vazhdon procesi i urbanizimit në kuptimin e tij të gjërë¹⁰.

Fillet e transformimit të fshatrave në komunën e Dragashit i hasim që nga vitet e gjashtëdhjeta. Me siguri këtu ka ndikuar në rradhë të parë bartja e elementit urban nëpërmjet gurbetçinjeve prej qëndrave të ndryshme urbane anekënd Evropës e Botës. Kështu pjesa më e madhe e fitimit është investuar pikërisht në përmirësimin e kushteve të jetesës, në ndërtimin e shtepive dhe objekteve tjera përciellse dhe në ngritjen e standardit jetësor.

Transformimit të fshatrave në komunën e Dragashit i ka kontribuar edhe përkundër pasivitetit ekonomik dhe izolimit gjeografik, elektrifikimi i hershëm falë ndërtimit të hidrocentralit "Dikanca" në Dikancë. Kështu kjo komunë është ndër regionet e para rurale Kosovare të elektrifikuara.

Elektrifikimi u bë bazë për depërtimin e radios, televizorit, shporetit elektrik etj. Fill pas elektrifikimit për një kohë të shkurtër fillon ndërtimi i ujësjellësit e kanalizimeve dhe menjëherë pasojnë banjot, makinat rrobalarëse etj.

Asfaltimi i rrugës Prizren-Dragash dhe përmirësimi i rrugëve lokale ndikoi në shtimin e automjeteve dhe makinave bujqësore. Ndërrohet në përgjithësi fizionomia e fshatit me shtepi moderne, shkolla, ambulanca, shitore etj.

Poashtu hetohet një transformim në familje ku familja e madhe gjithnjë e më tepër po zëvendësohet me familjen e vogël, në të cilën po organizohet një mënyrë e re e jetës dhe vazhdimisht po zhduken shenjat e trashëguara patriarkale¹¹.

⁹ Me urbanizëm në kuptim të ngushtë nënkuptohet, rritja e popullsisë qytetare në një vend, ndërkaq në kuptim të gjërë kuptohet zgjerimi i ndikimit të qytetit në fshatrat përreth.

¹⁰ Mr. Hajriz Meleqi, Opoja studim kompleks gjeografik, Desertacion i doktoraturës, fq.223.

¹¹ Mr. Hajriz Meleqi, Opoja studim kompleks gjeografik, Desertacion i doktoraturës, fq.223.

ANALIZA HAPESINORE

ANALIZA HAPESINORE – KOMUNA E DRAGASHIT

Sa i përket tipit të objekteve të banimit, ato janë të gjitha individuale, në përjashtim të një numri shumë të vogël të objekteve kolektive që gjenden në qytezën e Dragashit. Objektet e banimit individual (shtëpitë) janë hapësirat banimore për gati tërë popullsinë e kësaj komune, dhe ato janë kryesisht tip i shtëpive moderne, me materiale të eksportuara dhe mjaftë kualitative, dhe me hapësirë të mjaftueshme banimore.

Të gjitha këto elemente që i përmendëm më lartë tregojnë se kualiteti i banimit në komunën e Dragashit nuk është edhe aq i ulët. Megjithatë, është e nevojshme që edhe më tej të përmirësohet kualiteti i banimit për popullatën e kësaj komune. Kërkohej ende hapësirë më e madhe banimore, përmirësim e infrastrukturës përciellse (ujësjellesit, kanalizimit, telefonisë, sistemit të rrugëve etj.), të shërbimeve sociale (shëndetësore, arsimore, administrative etj.).

Rekomandimet:

- Zgjerimi i zonës urbane
- Vlerësimi i kapacitetit urban për banim
- Identifikimi i zonave dhe vendeve
- Vlerësimi i nevojave lokale për banim
- Ofrimi i banimit të volitshëm (jo të shtrenjtë)
- Monitorimi i Banimit të volitshëm
- Gjelbërimi në zonat e banimit

8. Zonat e rrezikuara nga vërshimet dhe erozioni

Komuna e Dragashit është e pasur më burime ujore . Territori i Komunës së Dragashit ka një rrjet të dendur hidrografik , i cili i takon pellgut të detit Adriatik . Komunën e Dragashit e përbëjnë dy lumenjë kryesor me degët e veta : Lumi Pllavës dhe Lumi Restelica .

Lumi Pllava buron në afërsi të Gurit të Zi. Ky është edhe burim i lumit të Zapllugjës në malet e Sharrit. Në bazë të të dhënave nga Instituti Hidrometeorologjik prurja mesatare ujore në pikën matëse në Orqushë është $5.26\text{m}^3/\text{s}$. (të dhëna të vitit 1980-91 në IHMK)

Raporti përmbledhës i shfrytëzimit të tokës në raport me sipërfaqet ujore është me sa vijon: Lumë 130 ha, prrua 65.02 ha, jazë 1 ha , knetë 4.56 ha, pra gjithsej llogaritet se sipërfaqe ujore është 200 ha ose 0.5 % e sipërfaqës së përgjithshme të territorit të Komunës.


Në bazë të të dhënave në komunën e Dragashit nuk ka shkallë rrezikshmërie nga vërshimet.

Rekomandimet

- Rregullimi i shtratit lumor mbi baza natyrore
- Pastrimi i shtratit të lumit nga mbeturinat e ngurta
- Eliminimi i pengesave natyrore përgjatë shtratit të lumit etj.

EROZIONI

Erozioni rrezikon natyrën dhe begatitë e krijuara dhe të planifikuara të



njeriut. Ai manifestohet me degradimin e tokës bujqësore dhe pyjore, të bimëve, me bartjen dhe akumulimin e materialit eroziv, i cili ndikon në sipërfaqet bujqësore dhe në vendbanime.

Rreth 6000km² ose 56% e territorit të Kosovës është e rrezikuar nga kjo dukuri natyrore që i takon shkallës së I,II,III të erozionit, (I-erozion shumë i fortë, II-erozion i fortë dhe III-erozion i mesëm)

Edhe në territorin e Dragashit është prezent faktori natyror erozioni që rrezikon me humbje të tokës bujqësore dhe dëme të mëdha në ekonomitë familjare.

Erozioni është dukuri natyrore prezente në territorin e komunës së Dragashit.

Në bazë të analizave të paraqitura në hartë janë ndarë këto kategori të erozionit. Në bazë të të dhënave shkallë të lartë të rrezikshmërisë erozive janë përfshirë 14575ha ose 24%e sipërfaqes së komunës, ku shkalla e rrezikshmërisë është në rritje si pasojë e faktorëve natyror dhe faktorit njeri.

Shkalla e erozionit	Sip.ha	%
Pa erozion		
Erozion shumë i dobët	11765.47	27.5
Erozion i dobët		
Erozion i mesëm	16651.59	38.5
Erozion i fortë	8682.43	20.1
Erozion shumë i fortë	5893.38	13.9

Zonat me te rrezikuara ne Komunene e Dragshit janë: Zona e fshatit Restelicë, Zlipotoku, Krushevë, Brodë, Gllboçicë, Baçkë, Dikancë, Mlikë, Kikjan, Leshtanë, Vranishtë, Xëerx, Pllajnikë dhe Rrencë


Faktorët që ndikojnë në shkallën e lartë te erozionit janë:

- Kushtet meteorologjike
- Pjerrtësia e terrenit
- Përbërja gjeologjike
- Flora dhe fauna
- Shkatërrimi i pyjeve
- Shfrytëzimi i inerteve etj


Rekomandimet për erozion

- Meliorimi i pyjeve
- Ndërtimi i brezave mbrojtëse në shpatiet e rrëpishme
- Parandalimi i prerjes ilegale të pyjeve etj.

Masat për parandalimin e shkallës së lartë të erozionit janë të paraqitura në hartë.




Masat kundër erozionit në territorin e komunës së dragashit



9. Ndotja dhe degradimi i mjedisit

Gjendja mjedisore në Kosovë nuk është e knaqshme, mirëpo komuna e Dragashit nuk ballafaqohet shumë me këtë problem sikurse komunat tjera.

Ajri - Kjo komunë krahasuar me të tjerat nuk është e preokupuar shumë me problemin e ndotjes së ajrit në kuptimin global për shkak të nivelt të dobët të urbanizimit dhe funksionit të dobët të industrisë, mirëpo prap se prap nuk mund të themi se nuk ka ndotje të ajrit, sepse si shkaktar i ndotjes mund të meret: komunikacioni në zonën urbane.



Toka - Teritori i kësaj komune ballafaqohet me problemin e ndotjes së tokës. Në secilin vendbanim, afër shtretërve të lumenjëve dhe hapësirave tjera të vendbanimit hasen grumbuj të mbeturinave dhe atë: amballazhe të ndryshme, plastikë, mbeturina të tekstilit, të drurit, të automjeteve, matale të ndryshme etj. Sistemi i grumbullimit të mbeturinave është i organizuar në qytezën e Dragashit dhe së fundi ka filluar edhe në disa fshatra të komunës.

Rekomandimet:

- Menaxhimi i mirë i mbeturinave në përgjithësi
- Ripyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura të pyjeve
- Menjimi i materieve të rrezikshme

Uji - Teritori i Komunes së Dragashit ka një rrjetë të dendur hidrografik , i cili i takon pellgut te detit Adriatik.

Komunën e Dragashit e përbëjnë dy lumenjë kryesor me degët e veta: lumi Pllavës dhe lumi Restelica .

SHKALLËT E NDOTJES SË LUMENJEVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË DRAGASHIT



Lumi Pllava buron në afërsi të Gurit të Zi. Ky është edhe burim i lumit Zaplluzhë në malet e Sharrit dhe deri në fshatin Zym i takon kategorisë së parë te ndotjes (lum i pastër). Lumi Pllava nga fshati Zym e deri në dalje te kufirit te komunës për shkak te shkarkimit te ujërave të zeza në rrjedhën lumore kalon në shkallën e ndotjes së kategorisë II-b

Shkarkimi i ujërave të zeza në rrjedhet lumore pa trajtim paraprak rritë shkallën e ndotje së lumit Pllavë .

Ç’do banor shkarkon 16.46m³ ujëra te zeza.

Komuna e Dragashit shakarkon 19 l/s ose brenda vitit shkarkon rreth 31160 m³ (vetëm qyteza e Dragashit) ujëra të zeza të pa trajtuar duke llogarit që të gjithë banorët kanë qasje në kanalizim te qytetit dhe pa llogaritur objektet shoqërore, industriale dhe objektet e shërbimeve të ndryshme.

Në bazë të Strategjisë për trajtim te ujërave të zeza e punuar nga Ministria e punëve te jashtme e Finlandës dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor-Departamenti i ujërave janë dhënë dy variante për trajtim të ujërave të zeza:

- Varianti 1-Trajtim i decentralizuar i ujërave të zeza sipasë së cilës çdo qytet /fshat e ka impiantin e vet për trajtimin e ujërave të zeza. Preferohet ky variant për komunën e Dragashit, njëherit ekziston edhe projekti ideor i komunës për impiantin në mes të fshatrave Kërstec dhe Orqushë ku do të bëhet pastrimi i ujrave të zeza dhe ka mundësi të kyçjes së 70 % të fshatrave.
- Varianti 2-Trajtim i centralizuar i ujërave të zeza me vetëm me një implant trajtues të ujërave të zeza në secilën prej shtatë kompanive regjionale ujore ku më vonë mund te kyqen edhe zonat rurale për rreth impiantit. Në këtë variant komuna e Dragashit parashihet të përfshihet në impiantin regjional të Prizrenit i cili planifikohet të ndërtohet në afërsi të fshatit Villashnje në drejtim të rrjedhës së lumit Lumbardhi i Prizrenit.

Përveq ujrave të zeza si ndotës dhe degradues të ujrave janë edhe mbeturinat ilegale që i hedhin popullata lokale në shtretërit e lumenjëve, nxjerrja ilegale e

rërës, shkatërimi i flores pran brigjeve të lumenjëve, shperlarja e tokës gjatë reshjeve atmosferike objektet industriale etj.

Rekomandimet:

- Përcaktimi i lokacionit për impiant nga komuna varësishtë se cili variant i përshtatet
- Mbledhja e fondeve nga komuna, qeveria, donatorët për ndërtimin e impiantit për pastrimin e ujërave të zeza.
- Ndalim- shkarkimi i ujërave industriale në rrjedhjet ujore .
- Të rregullohet me ligj që ç' do objekt industrial të ketë edhe mekanizmin e pastrimit të ujërave të zeza dhe industriale.
- Të rregullohen shtretërit e lumenjëve
- Ndalimi i nxjerrjes ilegale të rërës
- Ndalimi i qarkullimit të mjeteve motorike në ujërat e lumenjëve .

10. Shfrytëzimi joracional i resurseve natyrore

Terreni i komunës së Dragashit me pasuri mbitokësore dhe nëntokësore paraqet potencial të mirë për një zhvillim të gjithëmbarshtëm. Vargmalet e Sharrit paraqesin potencial të mirë për zhvillimin e turizmit por edhe të blegtorisë. Megjithë faktin se pjesa e maleve të Sharrit që i takon komunës së Dragashit dhe e cila lidhet ma malin e Koritnikut, i cili mal paraqet rezervat unikat në Europë për disa lloje të bimëve, kjo pjesë nuk është përfshirë në kuadër të parkut kombëtar “Malet e Sharrit” nga ana e pushtetit të atëhershëm. Parku përfshin një sipërfaqe prej 39.000Ha të cilat shtrihen në pjesën jugore të Kosovës, ky teritor përfshin pjesët e komunave: Prizren(19.500Ha), Shtërpçë(15.210Ha), Suharekë (2.730Ha), Kaqanik(1.560Ha). Administrata e parkut kombëtar planifikon që në të ardhmen ti propozoj MMPH-së zgjerimin e kufijve të parkut që në të të përfshihet edhe një pjesë e territorit të komunës së Dragashit ku gjenden disa zona me veqori dhe bukur të rralla natyrore, të cilat shtrihen përreth kufirit administrativ komunal të Dragashit me Prizrenin. Në kuadër të territorit të Dragashit zonat të cilat planifikohen të hyjnë në kuadër të PN “Malet e Sharrit” janë:

- Guri i Zi - Tereni i skijimit
- Rajoni i Brodit - Rezervat natyror (dhia e egër)
- Rajoni i Restelicës - Zonë ku gjenden pejsazhet e bukura si dhe liqene me mbi 2000 m lartësi mbidetare
- Bredhiku - Pyjet e pastra të bredhit
- Koritniku - Pyjet e pastra (Pinetum heldreichii)

Sa i përket sipërfaqes me pyje në këtë komunë ajo arrin deri 6.480 Ha, dhe atë në sektorin publik 4.851 Ha kurse në sektorin privat 1.629 Ha.

Pasurit minerare

Nga viti 1984 deri në vitin 1986 janë bërë disa hulumtime gjeologjike në komunën e Dragashit, nga ana e Institutit të specializuar gjeologjik “Geozavod” nga Beogradi. Qëllimi kryesor ka qenë që të njihet komuna me potencialin e pasurive minerare në territorin e saj. Hulumtimet tregojnë se nga struktura e mineraleve është konstatuar se bakuri gjendet në sasi më të theksuar. Sipas analizave të kryera bazeni përfshin një sipërfaqe duke filluar nga fshati Gllobaqicë dhe shtrihet gjerë në fshatin Bresanë. Prezenca e mineralit është sipërfaqësore dhe sipas analizave kimike ajo strukturë është deri në 8 %. Miniera më e madhe e bakurit është në Brod dhe ka përqindje 0.04 %. Në komunë është e nevojshme që të kryhen analizat gjeofizike për të konstatuar

ANALIZA HAPESINORE


ANALIZA HAPESINORE – KOMUNA E DRAGASHIT

rezervat prezente në këtë teritor dhe kjo në kuadër të studimit të fizibilitetit për shfrytëzimin e kësaj pasurie.

Rekomandimet:

- Shfrytëzimi racional i resurseve natyrore
- Të ndërpritet ç'do intervenim hapësinor në zonat me interes të veçant për vendin

Eksplorimi i resurseve natyrore posaqërisht atyre mbitokësore të jetë i kushtëzuar me rehabilitimin dhe rikultivimin sipëfaqësor.



11. Zhvillimi i pabarabartë ekonomik

Historiku i zhvillimit ekonomik të Komunës së Dragashit


Ekonomia e komunës së Dragashit, sikurse edhe çdo pjesë tjetër e Kosovës, pas Luftës së Dytë Botrore është zhvilluar në kuadër të ekonomisë së RSF Jugosllavisë . Që në fillim kjo ekonomi ishte orjentuar në zhvillimin e industris ndërsa veprimtaritë e tjera ishin në plan të dytë, mirëpo përkundër premtimeve për të investuar në zhvillimin ekonomik te Komunës së Dragashit ajo mbeti komuna më pak e zhvilluar jo vetëm në ish Jugosllavinë, por edhe në Kosovë. Edhe ato pak investime që u bënë , të gjitha ishin të orjentuara në Dragash , si qendër komunale, ndërsa viset rurale mbeten si regjione më të pa zhvilluara. Shkaqet e mos zhvillimit janë të shumta prej të cilave do të veqim disa: Komunë e izoluar malore me lartësi të mëdha mbidetare, pa infrastrukturë, regjion i brezit kufitar me Shqipërin etj. Historikisht popullsia e kësaj ane ka qen e lidhur më këto veprimtari: Lavartari , Blegtori dhe pylltari, pasi që ka bazë natyrore të përshtatshme për zhvillim, por prodhimi ekstenziv dhe dendësia e madhe agrare ndikuan në nivelin e ulët të zhvillimit.

Në vazhdim do të japim një pasqyrë mbi shpërndarjen hapësinoe të veprimtarive ekonomike në fshatrat e komunës së Dragashit , ku si çështje e trajtuar është:

Për të vlersuar dhe analizuar shpërndarjen dhe gjendjen e veprimtarive ekonomike në komunën e Dragash janë marrë këta indikatorë;

- ✓ numri i bizneseve,
- ✓ lloji i bizneseve dhe
- ✓ numri i punëtorve të paraqitur gjatë regjistrimit të bizneseve.

Gjatë shqyrtimit të të dhënave të regjistrimit të bizneseve në vendbanime të Komunës së Dragashit numri i bizneseve të regjistruara në fshatrat e komunës së Dragashit është në disproporcion me atë se çka ushtrohet si veprimtari në praktikë në këto lokalitete të fshatrave.



Llogaritur sipas metodës së devijimit standard, Dragashi është qendra më e zhvilluar e cila gjindet mbi mesataren e zhvillimit. Duhet theksuar se ky nivel i zhvillimit të veprimtarive ekonomike të regjistruara është llogaritur vetëm brenda kufive të komunës së Dragashit, duke mos e krahasuar me nivelin e zhvillimit të Kosovës. Mbi mesataren e zhvillimit te komunes është Dragashi i cili merr pjes ne 29.5 % të

ANALIZA HAPESINORE

ANALIZA HAPESINORE – KOMUNA E DRAGASHIT

bizneseve të regjistruara, pastaj Restelica me 10.3 %, Bresana me 9.3 %, Brodi Kuki , Pllava dhe Rapqa. Ndërsa vendbanimet tjera janë nën mesataren e zhvillimit. Ndërsa për dy vendbanime nuk kemi informata.

Sa i përket numrit të punëtorëve të punësuar në biznes, ai sillet prej 1 deri në 4 puntorë. Kjo tregon faktin se bizneset e regjistruara në lokalitetet fshatare janë biznese të vogla.





Tabela : bizneset dominante, nuri i te punsuarve

Ndërsa sipas analizës së pjesmarres së veprimtarive dominante ekonomike, kemi këtë renditje të bizneseve:

- në rend të parë hyn "Tregtia me shumicë dhe pakicë",
- në rend të dytë "Hotelet dhe restorantet,

ZHVILLIMI I PABARABART EKONOMIK NË KOMUNËN E DRAGASHIT

- në të tretin "Transporti dhe depot",
- në të katërtin "Industria përpunuese", Bujqësia,
- gjyeta dhe pylltaria, dhe Ndërtimtaria.



Struktura e veprimtarive ekonomike, të bizneseve të cilat janë regjistruar si dhe shpërndarja e tyre jo proporcionale, jo e barabart në fshatra të komunës së Dragashit nuk i përgjigjet shpërndarjes së veprimtarive që do të ishte në interes jo vetëm të pronarëve të tyre, por do të ishte në interes të lokaliteteve fshatare dhe të zhvillimit Ekonomik të komunës në përgjithsi. Shkaqet e një zhvillimi të till duhet hulumtohen dhe analizohen duke marr për bazë edhe faktorët tjer

(kushtet klimatike, konfiguracionin e terrenit, shkallën e arsimimit, shërbimet në arsim, nivelin e shërbimeve shëndetësore, infrastrukturen...), në mënyrë që kjo gjendje të tejkalohet dhe të përmirsohet në mënyrë që të arrihet një nivel i zhvillimit të barabart në tërë komunën.

Tregtia

Pasi që tregtia zë vendin e parë si veprimtari ekonomike, do të japim një pasqyrë të sektorit të Tregëtisë në komunën e Dragashit.

Siqë u cek edhe më lartë sipas të dhënave të regjistrimit të bizneseve, tregtia zë vendin e parë, ndërkaq numri i të punësuarve i cili sillet prej 1-4, tregon se këto janë ndërmarrje tregëtare të vogla të cilat kryesisht mirren me furnizimin e banorëve të këtyre anëve me mallëra të konsumit të përditshëm ushqimorë dhe joushqimorë, ndërsa ditëve të premta kur është dita e tregut, tregëtarë të ndryshëm vijnë dhe plasojnë mallërat e tyre në tregun lokal. Treg të bagëtive në komunën e Dragashit nuk ka, edhe për kundër faktit që kjo trevë është trevë blegtorale.

Industria

Komuna e Dragashit nuk ka pasur industri të zhvilluar asnjëherë. Kapacitetet e vetme ekonomike kanë qenë "hidrocentrali i Dikancit", "Drateksi" dhe fabrika për përpunimin e bimëve mjekuese.

Dikur hidrocentrali i "Dikancit" prodhonte rrymë elektrike në kuadër të KEK-ut, sot ky hidrocentral nuk funksionon. "Drateksi" dikur si industri për tjerren e leshit ka plasuar mallin e vet jashtë Kosovës dhe ka pasur një numër të konsideruar të të punësuarve, por pas konfliktit në Kosovë të vitit 1999, ajo punonte me një kapacitet shumë të vogël dhe tërë prodhimin e plasonte në tregun e Kosovës. Aktualisht kjo fabrikë është privatizuar. Në fabrikën për përpunimin e frutave dhe bimëve mjekuese sot bëhet vetëm grumbullimi i frutave dhe bimëve mjekuese kurse përpunimi kryhet në Slloveni. Pas konfliktit të vitit 1999 ka filluar zhvillimi i industrisë në sektorin privat, dhe atë në industrinë përpunuese ushqimore siq janë përpunimi i mishit, drithrave.

Me një angazhim të mirfillt të komunës biznismenëve në krijimin e politikave të qëndrueshme për këtë komunë mund të arrihen rezultate të mira duke pasur parasysh mundësitë për prodhime ekologjike të cilat sot në bote janë të kërkuara. Kjo do të ndikonte në zhvillimin të qëndrueshëm ekonomik për komunën dhe më gjërë.

Bujqësia dhe veprimtaritë e saja në Komunën e Dragashit


E përbashkët për të gjithë bujqit e Dragashit është se asnjë familje nuk është në gjendje që të sigurojë të ardhurat e saja nga bujqësia. Sipas hulumtimeve të bëra rezultoi se asnjë familje nuk e siguron ekzistencën nga prodhimet bujqësore. Sipas llogarive të bëra nga ana e zyrtarëve familjet të cilat posedojnë mbi 3Ha tokë të punëshme arrijnë të sigurojnë të ardhura nga bujqësia në vlerë prej 1000-3000 euro në vit.

Sipërfaqja e vogël e tokës së punëshme bujqësore, periudha vegjetative e shkurtër, rendimentet nën mesatarën e Kosovës kanë ndikuar që kjo degë të mos jetë burim i të ardhurave për ekonomitë familjare.

Kjo mund të shifet edhe nga diagrami më poshtë në të cilin paraqitet një ilustrim i gjendjes në komunë sipas vendbanimeve duke marrë për bazë numrin e familjeve që jetojnë nga bujqësia, numrin e familjeve që jetojnë nga blegtoria, prodhimtaritë bujqësore për konsum familjar si dhe prodhimtaritë bujqësore për konsum komercial.


ANALIZA HAPESINORE

ANALIZA HAPESINORE – KOMUNA E DRAGASHIT



Sa i përket **perimokulturës** si veprimtari bujqësore, ne kete komunë përkundër faktit se ekzistojnë kushte të përshtatshme klimatike për kultivimin e të gjitha llojeve të pemëve, nuk ekziston asnjë rast qe ato të kultivohen për konsum komercial. Kryesisht ato kultivohen nëpër kopshte shtëpiake dhe furnizimi behet prej viseve të tjera. Këto treva janë të përshtatshme për kultivimin e llojeve të ndryshme të pemëve të imta, të cilat tani rriten në formë të egër, të cilat edhe grumbullohen nga

SHKALLA E ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË NË KOMUNËN E DRAGASHIT



një numër i banorëve.

Bazuar ne kushtet e përshtatshme për rritjen dhe kultivimin e perimeve dhe bimëve mjekuese që gjinden në këto anë, këto produkte do të paraqisnin një bazë të fortë për industrin përpunuese njëkohsisht si një burim i të ardhurave familjare.

Në bazë të strukturës së shfrytëzimit të tokës 62% të sipërfaqes janë kullosa, 13% livadhe, që së bashku përfshijn 75% të teritorit të komunës. Këto paraqesin bazë të mirë për të zhvilluar blegtorinë, por në rastin e kësaj komune kemi një kundërthënje në mes të sipërfaqeve dhe numrit të kultivuesve të bagëtisë. Në fakt numri i gjedheve dhe deleve është në rënje sidomos viteve të fundit. Blegtoria është veprimtari tradicional e banorëve të këtyre anëve, këto produkte janë ekologjikisht të pastërta fal

kushteve klimatike si dhe mos pasjes së industrisë.

Marraja më intenzive, si dhe stimulimi i blegëtorëve do të ishte një hap i mirë si në rritjen e ekonomisë së vet blegëtorëve të komunës dhe me ndikim në ekonominë e mbarë Kosovës, bazuar në atë se sot në mbarë tregun botëror është një kërkesë për prodhimet ekologjike.

Bletaria është një sektor shumë i suksesshëm në komunën e Dragashit falë kushteve klimatike, ambientit të pastërt dhe mungesës së industrisë.

Turizmi dhe potencialet turistike

Pozita gjeografike, klima, hidrografia, flora dhe fauna dhe trashëgimia kulturore janë pasurit më të qmueshme të teritorit të komunës së Dragashit, të cilat janë potencial permanent për zhvillimin e turizmit si sektor i rëndësishëm ekonomik. Mirpo përkundër pasurive natyrore të përshtatshme për zhvillimin e turizmit mungon infrastruktura adekuate, mungon kuadri profesional, mungojnë njohuritë për turizmin në mënyrë që ai të ngritet në shkallë të lartë dhe të bëhet konkurent me turizmin e vendeve tjera.

Pozita gjeografike, kushtet klimatike, terrenet e përshtatshme, janë predispozita për zhvillimin e këtyre llojeve të turizmit:



Turizmi rekreativ dhe sportiv dimëror

Hulumtimet e ekspertëve të ndryshëm tregojnë se terrenet më të përshtatshme në teritorin e maleve të sharrrit janë ato të cilat bëjnë pjesë në komunën e Dragashit dhe në lartësi mbidetare mbi 1.100 metra. Këtyre tereneve të skijimit ju nevojitet shtresë e hollë e borës që ato të shfrytëzohen, si dhe klima e përshtatshme e cila mbretron në këto anë mundëson që këto terene të shfrytëzohen për aktivitete dimërore deri në 6 muaj në vit. Zonat ku mund të zhvillohet skijimi janë: Zaplluxha, Radesha, Brodi dhe Restelica. Këto terene mund të pranojnë deri në 30.000 mijë skijatorë në të njëjtën kohë. Është karakteristike se këto terene mund të shfrytëzohen edhe për skijim mbi barë.

Turizmi malor

Terrenet me pjerrtësi të lehtë si dhe stazat ekzistuese të cilat i përdorin blegëtorët, paraqesin një mundësi shumë të mirë për zhvillimin e alpinizmit, hecjes dhe shëtitjes malore me biçikleta. Ky lloj i turizmit ndërlihet me zhvillimin e sporteve të tjera malore që mund të zhvillohennë këto anë.

Turizmi tranzitor

Planifikimi për hapjen e vendkalimeve kufitare (2 vendkalime me Shqipërinë dhe 2 të tjera me Maqedoninë) që do të mundësonte lidhjen e kësaj komune me autostradën, ofron mundësi reale për zhvillimin e turizmit tranzitor.

Efektet ekonomike do të ishin të shumëfishta, pasi që turizmi do të nxiste edhe shumë aktivitete ekonomike jashtë veprimtarisë strikte turistike si rritjen e transportit, prodhimin e artikujve ushqimorë, bujqit që të merren me përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, shërbimet e ndryshme tregtare etj.

Taksat e qëndrimit të vizitorëve dhe taksat tjera do të plotësonin buxhetin komunal, të gjitha këto do të kishin edhe një efekt të rëndësishëm ekonomik.

Rekomandimet bazuar në Zhvillimin Ekonomik

Qëllimi i kësaj analize hapësinore të komunës së Dragashit është identifikimi i nivelit të zhvillimit ekonomik për çdo vendbanim të komunës, si dhe mundësit e një zhvillimi të barabart.

Shikuar nga analiza e regjistrimit të bizneseve dhe numrit të punsuarve shohim se 90% e venbanimeve gjindet nën mesataren e zhvillimit. Për të dalur nga kjo situatë prioritet numer një është rrehabilitimi dhe ndërtimi i infrastrukturës rrugore që mundëson lidhjet ma të mira të venbanimeve me qendrën si dhe hapja e pikave kufitare me Maqedoninë dhe Shqipërinë, të cilat do të jepnin një ndihmes të madhe në zhvillim ekonomik. Kjo do të nxirrte banoret e kësaj komune nga bllokada jo vetëm ekonomike e njëherit do të ishte në interes jo vetëm për banoret e Komunës së Dragashit por edhe më gjër.

Komuna e Dragashit bazuar në pozitën, potencialet natyrore, strukturen e përshtatshme të popullsisë, numrin e madh të njerëzve në diasporë, traditat në blegtori, sipërfaqet e mëdha të kullosave, ka mundësi reale për një zhvillim, në dy fusha të rëndësishme ekonomike: **blegtori dhe turizëm**

Prandaj gjatë hartimit të politikave zhvillimore të komunës, si në Planin Hapësinor të




Kosovës poashtu edhe në planin zhvillimor të komunës të krijohen politika favorizuese për sektorët e blegtoris dhe turizmit. Kjo do të ofronte mundësi dhe zgjidhje për të gjithë banorët e komunës duke u ofruar nivel të dëshiruar, pjesëmarrje aktive në jetën ekonomike e në këtë mënyrë edhe përmirësimin e kualitetit jetësor.

12. Vendbanimet, shërbimet dhe infrastruktura


Rrugët dhe transporti publik

Rrugët - Në territorin e komunës së Dragashit ekzistojnë 7 drejtime rrugore me gjithsej 153 km rrugë, përmes të cilave kryhet qarkullimi i njerëzve dhe mallrave ndërmjet qytezës së Dragashit me vendbanimet (fshatrat) e saj dhe me komunën e Prizrenit. Me hapjen e vendkalimeve kufitare me Shqipërinë në Krushë dhe me Maqedoninë në Strezimir që nga viti 2002 Dragashi është i lidhur pjesërisht edhe me këto shtete (nëpër këto vendkalime kufitare kanë të drejtë të kalojnë vetëm personat dhe atë në numër të limituar). Prej 153 Km rrugë, 71 Km janë të shtruara me asfalt, ndërsa 82 km janë nga materiali guror. Gjendja e rrugëve në përgjithësi nuk është e mirë dhe komunikacioni nëpër to zhvillohet me vështirësi. E vetmja rrugë regjionale që lidhë Dragashin me Prizrenin është shumë e shkatërruar dhe shumë e ngushtë për qarkullim normal të komunikacionit.


Urat - Rrjeti rrugor i komunës së Dragashit ka 16 ura, prej tyre 13 janë nga konstruksioni i betonit të armuar dhe 3 ura janë nga konstruksioni i drurit. Një numër i urave është në gjendje të mirë fizike. Por në shumicën e tyre duhet intervenuar me meremetime sepse janë mjaft të dëmtuara. Përveç meremetimit të urave ekzistuese, rrjeti rrugor në Dragash ka nevojë edhe për ndërtimin e urave të reja.



Nga gjithsej 36 vendbanime në komunën e Dragashit, 15 vendbanime apo 42% e tyre kanë rrugë të asfaltuara jo të dëmtuara, ku jetojnë rreth 25.400 banorë apo 54% e popullsisë së komunës së Dragashit. Rrugë të asfaltuara të dëmtuara kanë 5 vendbanime (apo 14% e vendbanimeve të komunës) me 8.600 banorë apo 18% e popullsisë së komunës. Rrugë jo të asfaltuara kanë 16 vendbanime apo 44%, në të cilat vendbanime jetojnë 12.900 banorë apo 28% e popullsisë së komunës së Dragashit.



Shërbimi i transportit publik automobilistik - Transporti i udhëtarëve në komunën e Dragashit është përmirësuar dukshëm mirëpo ende ka mangësi të dukshme në këtë drejtim. Kjo vjen si pasojë e infrastrukturës së dobët rrugore, terrenit të thyer malor dhe linjave të pakta. Në shumicën e fshatrave transporti kryhet vetëm me makina, pasi që është e pamundur të qarkullojë autobusi nëpër rrugët malore të tyre.




Nga gjithsej 36 vendbanime të komunës në 17 prej tyre (apo në 47% e vendbanimeve të komunës) zhvillohet transporti publik automobilistik, ku jetojnë 27815 banorë apo 59% e popullsisë së komunës, kurse 19 vendbanime apo 53%, nuk kanë transport publik automobilistik apo 41 % e popullsisë së komunës së Dragashit.

Konkluzione

Përmirësimi i infrastrukturës rrugore do të ndikojë drejtpërdrejt në përmirësimin dhe zhvillimin e përgjithshëm të komunës dhe po ashtu do të mundësojë lidhje më të mira me viset tjera për faktin se deri më tani kjo komunë ka qenë mjaft e izoluar.

Infrastruktura rrugore si bazë elementare e zhvillimit të gjithmbarshëm të një territori, kërkon trajtim të posaqëm nga të gjithë faktorët me ndikim në sektorin e infrastrukturës rrugore. Zyrtarët komunalë si prioritet të parë në të gjitha planet e tyre paraqesin rehabilitimin dhe asfaltimin e rrugëve ekzistuese dhe hapjen e rrugëve të reja. Nevojat për investime në rrugët e komunës janë shumë të mëdha dhe nuk mund të mbulojnë asesi me buxhetin e vogël komunal. Si prioritetet imediate paraqiten rehabilitimi dhe zgjerimi i rrugës regjionale Dragash - Prizren. Kjo rrugë nuk është në kompetencë të komunës por në kompetenca të Ministrisë së Transportit dhe Postë - Telekomunikacionit. Si prioritet tjetër është edhe rehabilitimi dhe asfaltimi i rrugëve që lidhin Dragashin



me vendbanimet tjera. Ndërkaq si rrugë me prioritet të lartë dhe me ndikim të madh në tërë aspektet e jetës shoqërore dhe ekonomike të banorëve të komunës paraqitet rruga Prizren - Zapluxhe - Qendër e Skijimit, Guri i Zi (Kufi me Maqedoninë) - Tetovë. Kjo rrugë është iniciativë e përbashkët e komunave të Prizrenit dhe Dragashit. KFOR-i Turk dhe KFOR-i Gjerman kanë bërë hapjen e trasesë rrugore deri në afërsi të kufirit me Maqedoninë. Kjo rrugë është njëra ndër rrugët që do të ndikojnë në ekonominë e gjithmbarshme të rajonit, por njëherit do të bënte të mundshme lidhjen më të shkurtër të Tetovës me autostradën Durrës - Kukës - Prishtinë - Merdare.

Rehabilitimi dhe asfaltimi i rrugës Krushevë - Kufi me Shqipërinë dhe me Maqedoninë paraqitet si prioritet me çrast do të bëhet lidhja dhe komunikimi më i mirë ndërmjet komunës së Dragashit në përgjithësi, por edhe të minoritarëve Boshnjakë / Goranë në të dy anët e kufirit në veçanti. Këto dy rrugë kanë rëndësi nacionale dhe janë propozime të parapara edhe në Planin Hapësinor të Kosovës.

Përveç rrugëve të përmendura me ndikim të gjithmbarshëm dhe substancial në territorin e komunës kanë nevojë për meremetim edhe rrugët: Dragash - Radeshë, Dragash - Restelicë - Shtëpi e gjuetarëve, Dragash - Brod - Shtëpi e gjuetarëve, Rruga kryesore - Liqeni i Breznës. Edhe gjendja e urave është jo e mirë, prandaj si nevojë paraqitet rehabilitimi dhe zgjerimi i 4 urave ekzistuese.

Sistemi i Ujit të Pijshëm dhe Sistemi i Kanalizimeve Furnizimi me ujë të pijshëm

Njëra ndër pasuritë më të mëdha natyrore në komunën e Dragashit është uji. Numri i madh i burimeve, përrockave dhe lumenjve janë parakusht themelor që me ndihmën e donatorëve të ndryshëm sot të gjitha vendbanimet e komunës të kenë sisteme të ujësjellësit.

Megjithë ndërtimin e ujësjellësive në një numër të caktuar të vendbanimeve, kapaciteti i ndërtuar i sistemeve është i vogël dhe nuk i plotëson plotësisht nevojat e popullatës. Në komunën e Dragashit vepron "Njësia Punuese Dragash" e kompanisë "Hidroregjioni Jugor" me seli në Prizren. Kjo kompani përkujdeset për furnizimin e qytetarëve me ujë të pijes, mirëmbajtjen e rrjeteve të ujësjellësit dhe mirëmbajtjen e kanalizimeve.

Momentalisht Njësia Punuese e Hidroregjionit Jugor përkujdeset për sistemin e ujësjellësit të qytezës së Dragashit dhe bën furnizimin me ujë të pijes fshatin Pllavë. Edhe pse të gjitha vendbanimet kanë sistem të ujësjellësit, kompania nuk i ka nën mbikqyrje këto sisteme. Me regjionalizimin e kësaj veprimtarie do të fillojë aksioni dhe do të zhvillohen bisedime me fshatarët që sistemet e tyre të ujësjellësit, të jenë nën mbikqyrjen e NP "Hidroregjioni Jugor".

Sistemi i ujësjellësit të qytezës së Dragashit dhe të fshatit Pllavë furnizohet me ujë nga lumi i Radeshës, kompania e bën trajtimin e ujit, ndërsa analizat kryhen në entin higjienik të Prizrenit. Burimet në Radeshë nuk janë të mbrojtura, hapësira është e hapur pa kurfarë rrethoje mbrojtëse. Trajtimi i ujit kryhet përmes filtrave, zakonisht këto filtra duhet të servisohen çdo 4 vjet, ndërsa në sistemin e trajtimit të ujit në Dragash, këto filtra nuk janë servisuar për 20 vjet të tëra. Sasia e ujit të këtij sistemi është 30 litra në sekondë, ky është në fakt kapaciteti i projektuar i filtrave.


Rrjeti i kanalizimit dhe ujërave fekale

Për sistemin e kanalizimit që posedon qyteza e Dragashit përkujdeset kompania "Njësia Punuese Dragash" e "Hidroregjionit Jugor" me seli në Prizren. Përveç qytezës së voni edhe nëpër disa fshatra janë ndërtuar kanalizimet, por të gjitha

këto kanalizime të fshatrave janë ndërtuar pa e involvuar dhe pa e informuar fare këtë kompani. Kështu, që kompania nuk ka asnjë informatë në lidhje me parametrat e kanalizimeve të ndërtuara dhe gjendjen e tyre.

Të gjitha kanalizimet ekzistuese si ajo e qytezës së Dragashit, poashtu edhe të fshatarave nuk posedojnë sistem të trajtimit të ujërave të zeza. Pra, të gjitha ujërat e zeza të komunës derdhen nëpër lumenjtë më të afërt.

Nga 36 vendbanime të Komunës së Dragashit, 7 vendbanime apo 19 % të tyre me 8844 banorë apo 19 % e popullsisë së komunës janë të kyçur në sistemin publik të kanalizimit, kurse 29 vendbanime apo 81%, ku jetojnë 38091 banorë apo 81 % e popullsisë së komunës së Dragashit nuk janë të kyçur në sistemin publik të kanalizimit.



Konkluzion

Dragashi furnizohet me ujë të pijshëm nga burimet e lumit të Radeshës. Por duke pasë parasysh rrjetin dhe numrin e burimeve nëpër malet e Sharrit, Dragashi ka mundësi dhe duhet të furnizohet me ujë të pijes nga burimet e ndryshme që ekzistojnë në Restelicë.

Për sa i përket sistemit të kanalizimeve nevojë imediate paraqitet realizimi i projektit ideor të komunës për ndërtimin e qendrës për trajtimin e ujërave të zeza dhe të ndërtohet rrjeti i kanalizimit nëpër të gjitha vendbanimet e komunës.



Menagjimi i mbeturinave

Në Dragash vepron "Njësia Punuese Dragash" e "Eko Kompanisë" me seli në Prizren. Kjo kompani menagjon me mbeturinat e ngurta në komunën e Dragashit dhe në disa fshatra të komunës.

Sistemi i grumbullimit të mbeturinave është operacional në qytezën e Dragashit. Këto mbeturina deponoheshin në deponinë e përkohshme e cila nuk i plotësonte standardet, mirëpo ndërtimi i deponisë së përhershme në komunën Dragashit për 15 vitet e ardhshme ka ndikuar në përmirësimin e menagjimit të mbeturinave në këtë komunë.

Në shërbimin e largimit të mbeturinave janë të përfshira 20 vendbanime nga gjithsej 36 vendbanimet e komunës (apo 56% e vendbanimeve) me 27 877 banorë apo 59% e popullsisë së komunës, kurse 16 vendbanime (apo 44% e vendbanimeve) me 19058 banorë apo 41% e popullsisë së komunës nuk kanë shërbimin e largimit të mbeturinave.

Rekomandohet që shërbimi i grumbullimit të mbeturinave të zgjerohet në tërë territorin e komunës.



Furnizimi me energji elektrike

Komuna e Dragashit furnizohet me energji elektrike nga elektranat e Kosovës përmes largpërquesit 35 KV, që vjen nga Prizreni. Ndërkaq me sistemin e distribuimit të energjisë elektrike në komunën e Dragashit përkujdeset Distribucioni në Prizren, njësia punuese Dragash. Njësia punuese në Dragash është e vendosur në objektin pranë trafostacionit bazë dhe e njëjta ka një sallë të vogël dhe një zyrë të vogël, kjo hapësirë nuk ofron kushte të volitshme për punë normale të njësisë në fjalë. Njësia punuese Elektrokosova në Dragash në rrjetin e distribuimit posedon dhe menagjon me:

1. *Trafostacioni bazë në Dragash. TS 35/ 10 KV me dy Transformator energjetik me fuqi instaluese $S_n = 8 \text{ MVA} + 4 \text{ MVA} = 12 \text{ MVA}$, dhe me Hidrocentralin në Dikancë me $S_n = 2,5 \text{ MVA}$. Fuqia e tërësishme instaluese është $S_n = 14,5 \text{ MVA}$.*

2. *Rrjetat e tensionit të Lartë 10 KV:*

a) *Rrjeta ajrore 10 KV me gjatësi $L = 86 \text{ Km}$, me përques $Al - Fe$*

b) *Rrjeta kabllovike tokësore 10 KV me gjatësi $L = 1 \text{ Km}$*

3. *Rrjetat e tensionit të ulët 04 KV*

a) *Rrjeta ajrore me gjatësi $L = 140 \text{ Km}$, me përques $Al - Fe$*

b) *Rrjeta kabllovike tokësore 04 KV me gjatësi $0,5 \text{ Km}$*

c) *Rrjeta ajrore me kabëll gërshet 04 KV me gjatësi $L = 2,43 \text{ Km}$*

4. *Trafostacione TS 10/04 KV nëpër lokacione, (fshatra dhe në qytezën e Dragashit), Gjithsej janë 88 Transformator Energjetik me fuqi instaluese $S_n = 20,02 \text{ MVA}$ prej tyre:*

a) *TS 10/04 KV Piramid (konstrukcion druri), 6 Transformatorë Energjetik*

b) *TS 10/04 KV Kulla, 11 Transformatorë Energjetik*

c) *TS 10/04 KV Blinda, 7 Transformator Energjetik*

d) *TS 10/04 KV Shtyllë Hekuri, 64 Transformator Energjetik*

5. *Trafostacione TS 10/04 KV lokale që janë pasuri të KEK-ut , gjithsejtë janë 70 prej tyre*

6. *Trafostacione TS 10/04 KV në pronësi private (nuk janë pasuri e KEK-ut) janë gjithsej 18.*

Energjia elektrike ka filuar të përdoret në vitin 1957, kur edhe është aktivizuar hidrocentrali i Dikancit. Sot, ky hidrocentral nuk funksionon sepse turbinat janë të stërvjetëruara dhe duhet ndërruar. Infrastruktura e hidrocentralit është në gjendje të mirë, por makineria është jashtë funksionit. Po këtë vit pra, më 1957, është ndërtuar edhe rrjeti i distribuimit të energjisë elektrike. Ky rrjet është sot e kësaj dite në përdorim. Përveç ndërhyrjeve të vogla që janë bërë kohëve të fundit, në përgjithësi nuk është intervenuar asnjëherë në sistemin e distribuimit. Momentalisht furnizimi me rrymë elektrike është mjaft i dobët si pasojë e rrjetit të amortizuar.

Ndriçim publik - në komunën e Dragashit ka në këto vendbanime: Dragash, Bresanë dhe fshatrat e rajonit të Gorës që gjenden në vijën kufitare me Shqipërin.

Asistenca e gjertanishme

Që nga viti 1999 gjer më sot është ndërruar transformatori bazë në Dragash, janë vënë 9 transformatorë të rinj me kapacitet më të madh në 8 fshatra dhe janë bërë ca intervenime të vogla në disa shtylla të tensionit të mesëm dhe të ulët.

Konkluzion

Që nga viti 1999 shumë ekspertë ndërkombëtarë të energjetikës, që e kanë vizituar komunën e Dragashit kanë ardhë në përfundim që ky territor ka potencial për shfrytëzimin e fuqisë së erës për prodhimin e energjisë elektrike. Prandaj në një të ardhme pritet që komuna e Dragashit të jetë qendër, për prodhimin e energjisë elektrike ekologjike. Hidrocentrali i Dikancit është inspektuar nga ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë dhe kanë ardhë në përfundim së me investime në rehabilitimin e

këtij hidrocentrali, pra rehabilitimin e teknologjisë ekzistuese, ky hidrocentral do të jetë në gjendje të prodhojë 4 MW energji elektrike. Po ashtu terreni, rrethina janë të përshtatshme (në të njëjtën vijë), ofrojnë kushte ideale për ndërtimin edhe të dy hidrocentraleve tjera me teknologji të re, me çrast të tre hidrocentralet së bashku do të prodhonin rreth 28 MW energji elektrike. Sa për krahasim këtu vlen të përmendet se e tërë komuna e Dragashit gjatë stinës së dimrit, atëherë edhe kur është konsumi më i lartë i energjisë shpenzonë 12 MË energji elektrike.

Për një zgjidhje afatgjate të problemit me furnizim të energjisë elektrike ekspertët e lëmisë në fjalë por, edhe zyrtarët komunalë e shohin në rehabilitimin e Hidroelektranës së Dikancit si dhe ngritjen e Hidroelektranave të reja në të njëjtën vijë. Investimet e bëra nëpër trafot e vendbanimeve 20/04 KV dhe në disa rrjete të tensionit të mesëm dhe të ulët, nuk e kanë përmirësuar gjendjen në nivel të kënaqshëm me furnizim të energjisë elektrike.

Ndriçimi publik si element kyq i sigurisë për qytetarët e komunës së Dragashit duhet të ndërtohet edhe në vendbanimet tjera të komunës në të cilat nuk ekziston.

Telekomunikimet

PTK-ja ka njësinë e saj punuese në Dragash dhe shërbimi i saj i telefonisë fikse është po ai i cili edhe ka qenë. Rrjeti i telefonisë fikse ekziston në Dragash, Shajne dhe Brod. Teknologjia e telefonisë fikse është po ajo e cila ka qenë, pra teknologji e vitit 1939.

Nga gjithsej 36 vendbanime të komunës së Dragashit, vetëm 8 % e vendbanimeve të komunës (3 vendbanime)


me 3.777 banorë apo 8% e popullsisë së komunës së Dragashit janë të kyçur në rrjetin e telefonisë fikse,

Kurse 92% të vendbanimeve (33 vendbanime) me 43.158 banorë apo 92 % e popullsisë së komunës nuk janë të kyçur në rrjetin e telefonisë fikse.


(Raporti i telefonisë fikse sipas vendbanimeve dhe popullsisë është paraqitur edhe në mënyrë skematike).

Valët e telefonisë mobile nuk e mbulojnë tërë territorin e komunës. Nga 36 vendbanime të komunës së Dragashit,

27 vendbanime apo 75% e vendbanimeve të komunës me 34.596 banorë apo rreth 75% e popullsisë së komunës së Dragashit mbulohet nga valët e telefonisë mobile, kurse 9 vendbanime apo 25% e tyre me 12.339 banorë apo 25% e popullsisë së komunës nuk mbulohen nga valët e telefonisë mobile.



Shërbimet postare ofrohen në Dragash, Bresanë, Bellobrad, Krushevë dhe Brod, do të thotë në 13 % të vendbanimeve të komunës.




Konkluzion

Nevojat e popullatës por edhe të institucioneve janë enorme, për komunikim modern dhe të shpejtë.

Terreni malor, dimrat e gjatë e vështirësojnë jetën e banorëve, por kur kësaj i shtohet edhe mungesa e telefonisë dhe mungesa e sinjaleve televizive dhe asaj të radios, atëherë krijohet përshtypja se banorët e kësaj komune nuk i përkasin kësaj bashkësie dhe nuk jetojnë në këtë kohë. Nevojat për telefoni moderne dhe efikase janë të mëdha, ndërsa këto ekzistueset as për së afërmi nuk i plotësojnë nevojat e popullatës. Ndërsa për sa i përket planeve të PTK-së në lidhje me këtë qështje, Kuvendi Komunal nuk posedon asnjë informatë. Njësia punuese e PTK-së në Dragash nuk është në gjendje të ofrojë informata dhe zyrtarët komunal i orienton në drejtorinë qendrore në Prishtinë, për çdo lloj bisede në lidhje me telefoninë.

Banorët e komunës së Dragashit janë të detyruar që përmes faturave të rrymës të paguajnë për shërbimet e televizionit publik, e në fakt nuk kanë kurrfarë sinjali nga po i njëjti televizion. Prandaj, televizioni publik duhet të instalojë ritransmetues dhe përforcues në mënyrë që të mbulojnë vendbanimet e komunës me sinjal televiziv.

Zonimi i komunës së Dragashit sipas niveli të zhvillimit të infrastrukturës



Zhvillimi i përgjithshëm i infrastrukturës në komunën e Dragashit është i ndryshëm. Në disa zona vendbanimet kanë infrastrukturë më të zhvilluar dhe në disa të tjera më pak. Kryesisht vendbanimet e Opojës kanë shkallë më të zhvilluar të infrastrukturës në krahasim me vendbanimet e Gorës. (Harta e më sipërme tregon nivelin e përgjithshëm të zhvillimit të infrastrukturës në komunë).

Problemet më të theksuara hapësinore: Hapësira e komunës së Dragashit përballet me probleme të natyrave të ndryshme, duke filluar nga ato sociale, mjedisore, ekonomike dhe të infrastrukturës.

Popullsia e kësaj komune është progresive dhe siguron një zhvillim të qëndrueshëm demografik. Shkallët e larta të papunësisë, varfërisë dhe depopullimit (sidomos në disa fshatra më të thella malore), janë brengë serioze e kësaj komune. Në rast se vazhdojnë edhe në të ardhmen këto shkallë të larta të papunësisë, varfërisë dhe depopullimit, atëherë kësaj komune do të mund ti bie tërësisht perspektiva për të jetyar dhe vepruar, dhe kjo më pas do të rezultonte me depopullim masiv, që do të krijon probleme të tjera. Niveli i shërbimeve shëndetësore dhe arsimore është i ndryshëm sipas vendbanimeve dhe poashtu problemet janë të natyrave të ndryshme. Në disa vendbanime mungojnë objektet shëndetësore dhe arsimore, në disa të tjera hapësira e objekteve nuk është e mjaftueshme, pastaj ka raste të mungesës së kuadrit apo edhe kualifikimi jo adekuat i tyre.


Në aspektin mjedisor ka problemin e erozionit dhe në disa hapësira të cilat janë të paraqitura në hartën e erozionit, pastaj ndotja e lumit sidomos nga hudhja e mbeturinave dhe derdhja e ujrave të zeza.

Zhvillimi ekonomik i komunës ballafaqohet me probleme të ndryshme duke filluar nga mungesa e një plani konkret zhvillimor, pastaj pozita periferike e komunës dhe largë

qëndrave të zhvilluara urbane, mungesa e investimeve të nevojshme sidomos në zhvillimin e bujqësisë dhe turizmit (në teknologji, risi, etj.).

Mungesa e infrastrukturës së nevojshme për këtë komunë është faktor nga i cili rrjedhin probleme të ndryshme e poashtu ndikon edhe në thellimin e problemeve që i përmendem më lartë. Sistemi rrugor nuk është në nivelin e kënaqshëm. Rruga Prizren - Dragash ka shpejtësi jashtëzakonisht të kufizuar, një numër i konsiderueshëm i fshatrave nuk kanë rrugë të asfaltuara, dhe disa të tjera i kanë rrugët e asfaltuara por niveli i dëmtimit të tyre është në shkallë të lartë. Rrjeti i telefonisë fikse është shumë i kufizuar, ndërësa telefonia mobile edhe pse ka rrjet më të gjërë, megjithatë nuk e mbulon tërë territorin e komunës. Mungesa e kanalizimit dhe ujësjellësit në disa fshatra paraqet problem tjetër që duhet të konsiderohet si mjaft i rëndësishëm

Problemet më të theksuara hapësinore të komunës së Dragashit



Bartësit kryesor të zhvillimit të komunës:

Komuna e Dragashit posedon potenciale të rëndësishme në të cilat duhet të mbështetet zhvillimi i ardhshëm.


Potenciale për zhvillim janë resurset humane, sepse popullsia e kësaj komune është e re që formon një fuqi punëtore të madhe në numër. Në anën tjetër, traditat, doket, zakonet, folklori etj. që janë karakteristike në nivel të Kosovës janë potencial tjetër i rëndësishëm. Numri i madh i migranteve të cilët janë në gurbet janë një pasuri tjetër që mund të shfrytëzohen për investime në fusha të ndryshme ekonomike, por kërkohet që për ta të krijohen kushte dhe politika konkrete.

Natyra e kësaj komunë përbën potencialin më të madh: Përbërja gjeologjike dhe relievi karakteristik, klima, hidrografia, flora dhe fauna. Karakteristikat morfologjike të kësaj hapësire (majet e larta malore, shpatijet, lugina të ndryshme etj.), pastaj klima tipike malore në lartësitë më të mëdha dhe ajri tejet i pastër, japin mundësi të mira për zhvillimin e të gjitha llojeve të turizmit dimror dhe veror. Numri i madh i rrjedhave ujore, me ujë të pastër e të ftohtë, me rrjedha të shpejta etj. janë poashtu karakteristikë tjetër. Edhe për nga flora dhe fauna kjo komunë është mjaftë e pasur.

Në bazë të potencialeve natyrore që posedon komuna, zhvillimi ekonomik duhet të orientohet në zhvillimin e bujqësisë (blegtorisë, pylltarisë, lavertarisë, pemtarisë, perimtarisë, bletarisë dhe gjuetisë.) dhe të turizmit (rekreativ dhe sportiv dimror, malor, tranzitor, kulturor etj.), që do të konsiderohen si bartësit kryesor të zhvillimit ekonomik të komunës,

ndërsa aktivitetet tjera ekonomike që do të mund të zhvillohen dhe do të luajnë rrol mjaft të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik janë: Zejtaria, hoteleria dhe shërbimet. Zhvillimi i këtyre aktiviteteve ekonomike në komunën e Dragashit është paraparë edhe në Planin Hapësinor të Kosovës e kjo është e rëndësishme për koordinimin e politikave ekonomike në të dy nivelet qeverisëse, atë komunal dhe atë qendror. Krijimi i lidhjeve me Maqedoninë dhe Shqipërinë do të mundësojë që kjo komunë të jetë në lidhje më të mira me rajonin duke u krijuar edhe karakteri tranzitor i kësaj hapësire. Këto lidhje do të mundësojnë edhe ngritjen e mardhënieve ekonomike me këto dy shtete e sidomos në aspektin e turizmit.

Komuna e Dragashi - Bartësit e zhvillimit



Zhvillimi i ardhshëm ekonomik i komunës së Dragashit duhet të orientohet në zhvillimin e atyre sektorëve për të cilët ekziston baza e potencialeve natyrore. Kushtet natyrore mundësojnë zhvillimin e bujqësisë, turizmit, tregëtisë dhe disa aktiviteteve tjera më të vogla përcjellëse.

Bujqësia - Është veprimtaria më e rëndësishme ekonomike në komunën e Dragashit. Prandaj ajo duhet të largohet gjithënjë e më tepër nga gjendja ekstenzive dhe në një të ardhme të afërt të shndërrohet në bujqësi intenzive. Që të arrihet kjo, duhet të zgjidhen në fillim ato probleme që e mendojnë bujqësinë e kësaj komune e pastaj investimi në hapjen e objekteve industriale për përpunimin e produkteve që i prodhonë bujqësia e këtij regjioni. Realizimi i politikave konkrete në përkrahjen e blegtorëve të kësaj komune në drejtim të zgjerimit të veprimtarive të tyre është e një rëndësie të veçantë. Përgatitja e projekteve konkrete në zhvillimin e këtyre sektorëve ekonomik do të ketë përkrahje edhe nga qeveria qendrore, për faktin se për këtë rajon është paraparë zhvillimi i këtyre sektorëve ekonomik edhe në Planin Hapësinor të Kosovës i cili plan është miratuar nga Qeveria e Kosovës. Poashtu aktivitetet e tilla ekonomike për këtë rajon do të parashihen edhe në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik të Kosovës. Përkrahje do të kenë sidomos projektet që janë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm.

- Parcellat e vogla dhe dendësia e madhe agrare - janë një problem i bujqësisë së komunës së Dragashit i cili kërkon një politikë të veçantë të investimit në ekonomi të vogla dhe të hapjes së tokave të reja.

- Mekanizimi - Rritja e produktivitetit bujqësor varet shumë nga përdorimi i teknologjisë. Edhe pse vazhdimisht është rritur përdorimi i makinave për punimin e tokës, prap se prap kjo komunë ka nevojë për një mekanizim më modern.

- Investimet - Deri më tani ka patur investime që kanë ndryshuar gjendjen në bujqësinë e kësaj komune, por parakushtet që ka kjo komunë japin shpresë për investime më të mëdha dhe të mirëfillta për të ardhmen.

- Risitë - Kanë qenë prezente sidomos viteve të fundit, por është mjaft me rëndësi që në të ardhmen të aplikohen më shumë risi si në përmirësimin e racave të deleve dhe të gjedheve poashtu edhe në teknologji.

Turizmi - Pejsazhet e bukura të Sharrit, klima e shëndoshë, ajri shumë i pastër, numri shumë i madh i burimeve dhe gurrave të ftohta, numri i madh i lumenjve dhe luginave atraktive, pyjet, flora dhe fauna karakteristike, liqenet e cirqeve dhe liqeni i Opojës, tradita dhe zakonet, folklori, objektet e periudhës osmane, sasia e borës, terrenet e përshtatshme për skijim etj.¹² janë potenciale që i ka komuna e Dragashit për zhvillimin e turizmit.

Hapja dhe rregullimi i rrugëve në kalimet e reja kufitare me Maqedoninë dhe Shqipërinë, këtë komunë do ta shndërronte nga një rajon i izoluar në një rajon tranzitor dhe me pak investime do të mund të arrihej shkallë e mirë e zhvillimit të turizmit.

Ngritja e infrastrukturës turistike ku përfshihen hotelet, motelet, kampet si dhe oferta të tjera turistike (parqet, teleferikët, furnizimi me ujë, rrymë, rrugët e nevojshme) etj. janë faktorë kyq në zhvillimin e ardhshëm të turizmit. Poashtu edhe propaganda turistike luan një rol të veçantë në këtë drejtim.

Tregëtia - Deri para luftës, në eksportin e mallrave rol kryesor kanë luajtur organizatat shoqërore të kësaj komune. Me rritjen e prodhimit rritet edhe rëndësia e zhvillimit të tregëtisë. Për prodhimet bujqësore dhe blegtorale me rëndësi është që të sigurohet tregu, i cili me hapjen e kalimeve kufitare mund të zgjerohet edhe në Maqedoni dhe Shqipëri.

¹² Mr. Hajriz Meleqi, Opoja dhe Gora, Fq. 130
Ministria për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor
Instituti për Planifikim Hapësinor
Kuvendi komunal - Dragash
Nëntor, 2006

Treguesit dhe kriteret për vlerësim

1. Varfëria e lartë dhe në rritje:

Treguesit

Numri i banorëve me asistencë sociale
Numri i familjeve me asistencë sociale

Kriteri

- % e popullsisë së vendbanimit që marrin asistencë sociale:
0 - 4 % - tregon varfëri të ulët
4 - 22 % - varfëri e mesme
Mbi 22 % - varfëri e lartë

2. Papunësia e lartë dhe në rritje të vazhdueshme:

Treguesit

Numri i punëkërkuessve të paraqitur në zyrën komunale për punë dhe punësim

Kriteri

- % e të pa punëve në raport me tërë popullsinë e vendbanimit
0 - 6 % - papunësi e ulët
6 - 18 % - papunësi e mesme
Mbi 18 % - papunësi e lartë

3. Depopullimi i vendbanimeve:

Treguesit

Numri i banorëve sipas vendbanimeve në vitin 1998
Numri i banorëve sipas vendbanimeve në vitin 2005
Mesatarja e rritjës së popullsisë
Numri i pësonave të mbytur gjat luftës.

Kriteri

- % e popullsisë së shpërngulur sipas vendbanimeve prej vitit 1998 deri 2003
0 - 30 % - depopullim i vogël
30 - 80 % - dpopullim i lartë
Mbi 80 % - depopullim shumë i lartë

4. Shërbimet e ulëta arsimore dhe shëndetësore:

Treguesit

Objektet shëndetësore/nr. banorëve
Kudri shëndetësor/nr. banorëve
Kudri përkatës - kualifikimi i personelit mjekësor
Largësia e shërbimeve shëndetësore
Sipërfaqja shkollore/ nr. i nxënësve
Kudri arsimor/ nr. i nxënësve
Kudri përkatës - kualifikimi i mësimehdhënësve
Largësia e objekteve shkollore

Kriteret për shëndetësi:

1 mjek dhe 2 motra medicinale / 2000 banorë
1 ambulancë / 6000 banorë
1 QMF / 10 000 banorë
1 QKMF / 60 000 banorë

Kriteret për arsim:

5 m² / 1 nxënës

22 nxënës / 1 mësues

5. Shkatërrimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore:

Treguesit

Numri i objekteve kulturo-historike

Numri i objekteve arkeologjike

Lista e objekteve (zonave) natyrore të cilat IMNK-ja i propozon për mbrojtje

Kriteret

- Numri dhe rëndësia e objekteve me trashëgimi kulturo-historike sipas vendbanimeve

6. Humbja e tokës bujqësore:

Treguesit

Sipërfaqja e tokës bujqësore në komunën e Vushtrrisë në të gjitha fshatrat

Të dhënat nga Agjencioni Kadastral i Kosovës

Kriteri

- % e sipërfaqës së tokës bujqësore sipas vendbanimeve

15 - 31 %

31 - 47 %

47 - 63 %

63 - 79 %

Mbi 79 %

7. Banimi:

Kriteri

- Merren vlerësimet e qështjeve tjera (infrastruktura, shërbimet komunale, hapësirat përciellse etj.), të cilat japin si rezultat kualitetin e banimit dhe të jetës në përgjithësi

8. Zonat e rrezikuara nga vërrshimet dhe erozioni:

Treguesit

Të dhënat nga atllasi: Baza e hidroekonomisë së Kosovës

Të dhënat komunale për zonat e rrezikuara nga vërrshimet

Kriteret:

Vendbanimet dhe sipërfaqet e tokave bujqësore të rrezikuara nga vërrshimet.

Shkalla e erozionit (I, II, III, IV, V).

9. Ndotja degradimi dhe shfrytëzimi joracional i mjedisit:

Treguesit

Të dhënat komunale për ndotjen dhe degradimin e mjedisit

Të dhënat nga IHMK (Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës)

Të dhënat nga dokumenti - Strategjia e mjedisit

Rapor mbi gjendjen ambientale në Kosovë

Kriteret:

Shkalla e ndotjes në bazë të kriterëve të përcaktuara nga UE

Deponit ilegale në vendbanime

Shkarkimi i ujrave të zeza

Vendshfrytëzimet ilegale të pasurive natyrore

10. Zhvillimi i pabarabart ekonomik:

Treguesit

Informatat mbi organizimin e bizneseve, veprimtarit dhe numrin e të punësuarve në fshatrat e komunës së Vushtrrisë

Organizimi i bujqësisë

Potencialet turistike

Kriteret:

Numri i bizneseve dhe llojit të bizneseve për bashkësi lokale.

Numri i serave dhe lloji i tyre nëpër vendbanime

Vlerat natyrore për potencial turistik

11. Vendbanimet, shërbimet dhe infrastruktura:

Treguesit

Vendbanimet nëpër të cilat kalojnë rrugët e asfaltuara

Vendbanimet të cilat kanë shërbimet e transportit publik

Të dhënat për transportin hekurudhor

Të dhënat për furnizim me energji elektrike

Vendbanimet të cilat kanë rrjetin e ujësjellësit

Vendbanimet të cilat kanë rrjetin e kanalizimit dhe ujërave fekale

Vendbanimet të cilat janë të përfshira në largimin e mbeturinave

Kriteret :

% e vendbanimeve të komunës të cilat i kanë rrugët e asfaltuara

% e VB-ve të komunës të cilat i kanë të organizuar shërbimet e transportit publik\

% e VB-ve të komunës të cilët e kanë transportin hekurudhor

% e VB-ve të komunës të cilët e kanë rrjetin e ujësjellësit dhe % e banorëve të kyqur në të.

% e VB-ve të cilat e kanë rrjetin e kanalizimit dhe % e banorëve të kyqur në të

% e VB-ve të cilat janë të përfshira në rrjetin e grumbullimit të mbeturinave dhe

% e popullsisë të përfshira në të.

Në fund

Dokumenti Analiza Hapësinore e Komunës së Dragashit është rezultat i bashkëpunimit të ngushtë të Institutit për Planifikim Hapësinor në kuadër të Minsitrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunës së Dragashit. Ky angazhim është në kuadër të aktiviteteve të Institutit të parapara si ndihmë profesionale komunave të Kosovës në fushën e planifikimit dhe menagjimit të hapësirave komunale. Në bashkëpunim me autoritetet komunale kemi arritur që për një kohë relativisht të shkurtër të përmbledhim të gjitha të dhënat hapësinore që kanë të bëjnë me gjendjen, rekomandimet dhe mundësitë e zhvillimit të ardhshëm të Komunës. Konsiderojmë se përmbajtja e dokumentit është bazë e mjaftueshme të cilën komuna mund ta shfrytëzojë për hartimin e planeve zhvillimore komunal.

Bashkëpunëtorët dhe përgjegjësit:

Instituti për Planifikim Hapësinor

Përgjegjës kryesor - Luan Nushi U.D. drejtor

Përgjegjës për programin e analizave hapësinore - Arbën Rrecaj

Përgjegjës për projektin - Hazer Dana

Përgjegjës për qështje të caktuar - *Festa Nela
Shpend Agaj
Nexhmije Kamberi
Zana Mehmeti
Mimoza Kallaba
Ismail Gagica
Rizah Murseli
Ardiana Zhuri*

Kuvendi Komunal - Dragash

Strukturat e ndryshme komunale (të gjitha drejtoratet e KK të Dragashit)

Burimi i informatave

Një pjesë e madhe e të dhënave të përgjithshme për të gjitha çështjet janë marrë nga shërbimet komunale, një pjesë tjetër është marrë nga materialet më herët të edituar dhe disa nga të dhënat janë nxjerrë edhe nga Literatura.